RAPORTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT – MAQEDONIA E VERIUT 2021

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë së Veriut është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh ushtron pushtetin ligjvënës. Zgjedhjet presidenciale u mbajtën për herë të fundit në maj të vitit 2019 dhe u fituan nga presidenti Stevo Pendarovski. Zgjedhjet parlamentare u mbajtën në korrik të vitit 2020 pas një vonese tre-mujore për shkak të pandemisë me KOVID-19. Në deklaratën paraprake mbi zgjedhjet parlamentare në korrik 2020 dhe në Raportin përfundimtar në tetor 2020, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, konstatoi se zgjedhjet ishin "përgjithësisht të administruara me efikasitet përskaj përshtatjeve me kushtet e pandemisë së KOVID-19, por me stabilitet ligjor të cenuar nga ndryshime të konsiderueshme të Kodit Zgjedhor dhe miratimi më vonë i rregulloreve *ad hoc* gjatë gjendjes së jashtëzakonshme." Raporti i karakterizoi zgjedhjet si " vërtetë konkurruese" përkundër mundësisë së kufizuar të politikanëve për të vepruar në terren gjatë pandemisë. Dita e zgjedhjeve shkoi mirë.

Policia e shtetit ruan sigurinë e brendshme, përfshirë migracionin dhe menaxhimin e kufirit, dhe i përgjigjet Ministrisë së Brendshme. Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë. Pjesëtarët e forcave të sigurisë kryen disa shpërdorime, përfshi përdorimin e tepruar të forcës nga policia dhe rojet e burgut.

Shqetësime të mëdha në lidhje me të drejtat e njeriut përbënin raportet e besueshme për kushtet çnjerëzore dhe degraduese dhe mbipopullimin e rëndë në disa njësi burgimi, dhunën dhe kërcënimet me dhunë ndaj gazetarëve, rastet e korrupsionit serioz të qeverisë, mungesën e përgjegjshmërisë për dhunën në bazë gjinore si dhe dhunën në familje dhe për krimet që përfshijnë dhunën dhe kërcënimet me dhunë që kanë në shënjestër personat lezbikë, gej, biseksualë, transgjinorë, kuirë ose interseksualë.

Qeveria mori masa për të identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe për të ndëshkuar zyrtarët që kryen shpërdorime apo u përfshinë në korrupsion. Avokati i Popullit

vlerësoi se mosndëshkimi i policisë vazhdonte të ishte një problem, por në një shkallë më të vogël se në të kaluarën.

Pjesa 1. Respekti për integritetin e personit

a. Privimi arbitrar nga jeta ose vrasje të tjera të paligjshme ose për motive politike

Nuk pati njoftime për vrasje arbitrare apo të paligjshme të kryera nga ana e qeverisë apo përfaqësuesve të saj.

b. Zhdukje

Nuk pati njoftime zhdukjesh, nga ose në emër të autoriteteve qeveritare.

c. Tortura dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese

Kushtetuta dhe ligji i ndalon këto praktika, por ka pasur disa raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të tepërt. Qeveria ka vepruar për të hetuar dhe për të ndjekur pretendime legjitime. Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka raportuar se, gjatë shtatë muajve të parë të vitit, ka vepruar në lidhje me 38 ankesa për ushtrim të forcës së tepërt nga efektivë policorë. Njësia vlerësoi se gjashtë nga ankesat ishin të pabaza, ndërsa hodhi poshtë 30 prej tyre për mungesë provash dhe mbështeti dy. Në dy rastet e fundit, SSP paraqiti padi penale kundër dy policëve për "ngacmim gjatë kryerjes së detyrës."

Deri me 1 gushti, SSP kishte paraqitur ankesa penale në zyrën e prokurorisë kundër dy policëve për përdorim të tepruar të forcës. SSP sekuestroi armët e efektivëve dhe i urdhëroi ata t'u nënshtroheshin vlerësimeve psikologjike dhe psikiatrike. Dy ankesa disiplinore të veçanta të SSP të vitit 2020 kundër dy efektivëve të policisë për përdorim të tepruar të forcës rezultuan në gjobitjen e një nëpunësi nga komisioni disiplinor dhe ndërprerjen e punësimit të tjetrit. Më 10 nëntor, Gjykata Themelore e Manastirit dënoi një efektiv policie me një vit burg për përdorim të tepruar të forcës kundër një shtetasi rom në shtator 2020.

Deri më 20 gusht, Avokati i Popullit kishte marrë 51 ankesa kundër policisë, përfshirë dy për brutalitet policor. Me rekomandimin e Avokatit të Popullit, Zyra e Prokurorisë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (ZPKOK) hapi një hetim paraprak në një nga ankesat për akuzat e "keqtrajtimit në kryerjen e detyrës."

Shqyrtimi i ankesës së dytë nga Avokati i Popullit me pretendime për brutalitet ishte në zhvillim e sipër deri më 30 gushti.

Në 15 raste, parashtruesit e ankesave kërkuan ndërhyrjen e Avokatit të Popullit tek SSP për ndërveprime të paligjshme, joprofesionale dhe të papërshtatshme me qytetarët. Dy denoncime pretenduan sjellje të gabuar të policisë gjatë protestave. Avokati i Popullit vendosi se të dy ankesat qenë me bazë të mirë dhe i rekomando SSP-së të merrte masa disiplinore kundër efektivëve të përfshirë. Në rastin e parë, SSP tha se nuk mund të vepronte sepse nuk mund të identifikonte efektivin e përfshirë nga pamjet video në dispozicion. Në rastin e dytë, ndërmori masë disiplinore kundër efektivit për shkelje serioze të protokolleve të vendosura dhe paraqiti një ankesë penale në ZPKOK. 51 ankesat përbënin një rënie të ndjeshme në krahasim me 130 ankesat e paraqitura në të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Mosndëshkimi nuk ishte një problem i rëndësishëm tek forcat e sigurisë.

Kushtet në burgje dhe në pikat e paraburgimit

Pavarësisht përmirësimeve fizike në disa objekte, burgu i Idrizovës, i cili kishte afërsisht 45 përqind të popullsisë së burgjeve të vendit, vazhdoi të përdorte njësi që ishin të rrënuara, të mbipopulluara rëndë dhe i ekspozoi disa të burgosur ndaj kushteve çnjerëzore dhe degraduese. Korrupsioni i përhapur i personelit të burgjeve ishte një problem i rëndësishëm në sistemin e burgjeve.

Kushtet fizike: Në vizitën e tij më të fundit *ad hoc* në vend në dhjetor 2020, Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) i Këshillit të Evropës raportoi se, ndërsa kushtet e paraburgimit ishin përgjithësisht të pranueshme në repartet e hapur dhe gjysmë të hapur të burgut të Idrizovës, gjendja e vështirë, e vjetëruar dhe mbipopullimi vazhduan në godinën dykatëshe të burgut, të quajtur Ambulanta. Qelitë gjithashtu kishin ngrohje të dobët (15.5 gradë Celsius) dhe kishin lagështi.

Raporti i KPT-së nga vizita, i publikuar më 29 korrik, gjithashtu vuri në dukje gjetjen se "njësia e vjetër gjysmë e hapur" e Idrizovës, e cila duhej të rrënohej në vitin 2018, ende funksiononte brenda burgut "pranë rrënojave të punishteve të mëparshme dhe njësisë së pranimit." Lidhur me njësinë gjysmë të hapur, raporti i KPT thotë, "në kohën e vizitës, kishte 91 të burgosur të strehuar në 14 dhoma, disa prej të cilave ishin të mbipopulluara rëndë; për shembull, 16 persona në një hapësirë prej 32 metra katrorë. Dhomat ishin në gjendje të përkeqësimit të avancuar (mure të shkatërruara, korniza të dritareve dhe mobilje të thyera, tela elektrikë të improvizuar të rrezikshëm, vrima në dysheme dhe tavan) dhe higjiena e mjerueshme (infektim i

parazitëve, grumbuj plehrash në qelitë dhe depërtim i ujit). Objektet sanitare komunale ishin në gjendje të mjerueshme me tualetet e katit të parë që lëshonin erë të keqe dhe të mbuluara me fekale, rubinete dhe instalime uji që pikonin, dysheme të përmbytura dhe pa ndriçim artificial funksional." Në raportin e KPT-së thuhej: "Kushtet brenda kësaj njësie si dhe ato brenda Ambulantës mund të përshkruhen me siguri si çnjerëzore dhe degraduese."

Autoritetet e burgut i kanë mbajtur të burgosurit për periudha të gjata pa mundësi lëvizjeje. Për shembull, në raportin e KPT-së të 29 korrikut thuhet se në burgun e Shkupit, "sistemi ende ngjante me një gjurmë të së kaluarës. Personat në paraburgim vazhdonin të qëndrojnë të mbyllur në qelitë e tyre për më shumë se 23 orë në ditë pa asnjë aktivitet përveç 30-45 minutave në ditë në një nga dy oborret, të cilat ende nuk ishin pajisur me ndonjë pajisje për stërvitje." Ndërsa ishte ngritur një palestër me pajisje për ngritjen e peshave dhe biçikleta për stërvitje, përdorimi i saj ishte jashtëzakonisht i kufizuar dhe shumica e të burgosurve nuk ishin informuar për ekzistencën e saj ose se mund të hynin në të.

Në *Raportin e 30-të të Përgjithshëm* që mbulon vitin 2020 dhe u publikua më 27 maj, KPT vuri në dukje një numër problemesh, përfshirë menaxhimin e keq, korrupsionin endemik midis stafit të burgjeve, dhunën midis të burgosurve, kujdesin shëndetësor të papërshtatshëm, kushtet e këqija të jetesës (veçanërisht në burgun e Idrizovës) dhe praktikën e emërimit të drejtorëve të burgjeve dhe zëvendësve të tyre bazuar në përkatësinë politike. Raporti i KPT-së ishte në përputhje me konkluzionet e Mekanizmit Parandalues Kombëtar të vitit 2020 të Avokatit të Popullit lidhur me burgjet.

Ndonëse sistemi korrektues kishte kapacitet të mjaftueshëm, Avokati i Popullit raportoi se mbipopullimi u paraqit sërish si çështje gjatë vitit, veçanërisht në disa reparte të burgut të Idrizovës. Sistemi i burgjeve vazhdoi të vuante nga mungesa e fondeve dhe mungesa e personelit. Kushtet e këqija vazhduan në shumicën e stacioneve policore, strukturave të kujdesit social, strehimoreve dhe institucioneve psikiatrike.

Avokati i Popullit njoftoi më 20 gusht se autoritetet kishin rinovuar burgun e Manastirit dhe kishin hapur shtëpinë e re të korrigjimit të të miturve Volkovija, duke mundësuar transferimin e 16 shkelësve të rinj nga burgje të tjera në këtë strukturë të specializuar. Avokati i Popullit njoftoi megjithatë se kushtet e burgut vazhduan të jenë përgjithësisht të papërshtatshme, kryesisht për shkak të kujdesit të

pamjaftueshëm shëndetësor dhe shërbimeve arsimore/rehabilituese dhe mungesës së personelit të trajnuar.

Deri më 20 gushti, Mekanizmi Parandalues Kombëtar i Avokatit të Popullit kishte vizituar nëntë burgje dhe struktura korrektuese, duke u përqendruar në trajtimin e të varurve nga droga si veçanërisht të prekshëm ndaj trajtimit mizor dhe degradues. Avokati i Popullit zbuloi se autoritetet nuk ofruan mbrojtje, kujdes shëndetësor apo trajtim të përshtatshëm për këtë kategori të burgosurish, veçanërisht në burgun e Kumanovës. Avokati i Popullit i paraqiti Ministrisë së Shëndetësisë një raport të posaçëm me rekomandime për veprime zbutëse. Në një vizitë pasuese në Kumanovë më 5 maj, Avokati i Popullit vuri në dukje se autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe trajtimin e të burgosurve që vuanin nga varësia e drogës që nga vizita e tij e mëparshme.

Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve (DES) e Ministrisë së Drejtësisë njoftoi se pesë persona kishin vdekur në paraburgim deri më 17 gusht. DES tha se një vdekje ishte vetëvrasje dhe të tjerat ndodhën pas periudhave të zgjatura të shëndetit të lig. Avokati i Popullit hapi hetime mbi vdekjet e të pesë individëve. Hetimet mbetën pezull deri më 20 gusht.

DES mori 18 njoftime të brendshme për përdorimin e forcës kundër të burgosurve nga policia e burgut. Në të gjitha rastet, drejtoria kishte konstatuar se nëpunësit kishin vepruar në përputhje me procedurat standarde të operacionit. Pati dy ankesa që pretendonin torturën dhe trajtimin çnjerëzor të të burgosurve në burgjet e Manastirit dhe Kumanovës, ku këta të fundit pretendonin se rojet përdorën forcë të tepruar ndërsa reagonin ndaj dhunës së të burgosurve. Inspektimi i jashtëzakonshëm i burgut të Manastirit nuk mund të përcaktonte nëse përdorimi i forcës ishte i justifikuar, ndërsa inspektimi në burgun e Kumanovës zbuloi se përdorimi i forcës ishte i justifikuar dhe në përputhje me politikën dhe procedurat standarde.

Administrata: Deri në 20 gusht, Avokati i Popullit kishte marrë shtatë ankesa nga personat e ndaluar apo të dënuar që pretendonin përdorim të tepruar të forcës, brutalitet, torturë, trajtim çnjerëzor apo degradues dhe kishte shqyrtuar katër prej tyre. Dy ankesa u paraqitën kundër policëve dhe pesë kundër policëve apo rojeve të burgut. Tre roje të burgut u akuzuan për brutalitet në burgjet e Prilepit, Idrizovës dhe Manastirit. Pas kryerjes së vizitave në terren, Avokati i Popullit konstatoi se ankesat që përfshinin policinë e burgut të Prilepit dhe Manastirit qenë të pabaza. Pas një ankese kundër policisë së burgut të Idrizovës për keqtrajtimin e pretenduar të një të

burgosuri gjatë transportit në gjykatë, Avokati i Popullit lëshoi rekomandime ndaj autoriteteve të burgut lidhur me protokollet e transportit. Avokati i Popullit vizitoi rregullisht burgjet ku ishin paraqitur ankesa për të kërkuar prova që mbështesnin pretendimet e abuzimit në funksion të rekomandimit të veprimeve të mëtejshme.

Avokati i Popullit vuri në dukje se në përgjithësi, autoritetet kishin pranuar rekomandimet e tij, por nuk kishin ndërmarrë veprime të mjaftueshme për t'i zbatuar ato siç duhet. Avokati i Popullit kishte qasje të plotë dhe të papenguar në të gjitha burgjet dhe mjediset e burgimit.

Monitorimi i pavarur: Ligji lejon mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit nga KPT-ja dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq të kenë qasje te personat në paraburgim me miratimin e gjyqtarit hetues. Në pajtim me një memorandum mirëkuptimi të nëntorit 2018, qeveria i dha Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut qasje të pakufizuar te të burgosurit e dënuar. Avokati i Popullit vizitoi rregullisht, një herë në muaj, burgjet e vendit dhe hetoi pretendimet e besueshme për kushtet problematike dhe trajtimin e të burgosurve.

Përmirësimet: Ministria e Drejtësisë njoftoi për përmirësime në burgun e Idrizovës. Njësia e Korrigjimit të të Miturve në repartin femëror të burgut të Idrizovës u rinovua për të ndarë plotësisht të burgosurit e mitur nga të rriturit. DES-i njoftoi edhe për përfundimin e renovimeve në burgun e Tetovës.

DES vazhdoi trajnimin e efektivëve të sapo punësuar të policisë së burgjeve në Qendrën për Trajnim dhe Edukim. Qendra trajnoi 35 efektivë mbi operacionet standarde në mjediset institucionale, kodin e sjelljes së efektivëve dhe përdorimin e forcës.

Në një raport të 29 korrikut, KPT vuri në dukje se DES u ristrukturua për të përmirësuar efikasitetin e saj dhe për t'i dhënë përparësi trajnimit të stafit dhe shërbimit të probacionit (lirimit me kusht). Megjithatë, KPT ngriti shqetësime për praktikën e vazhdueshme të emërimit të drejtorëve të burgjeve dhe zëvendës drejtorëve nga jashtë sistemit të burgjeve dhe vuri në pikëpyetje ekzistencën e strukturës së duhur të përgjegjshmërisë që për bazë do të kishte jo vetëm përkatësinë politike.

KPT vuri në dukje se një vendim për t'i dhënë stafit të burgjeve një rritje page prej 30 përqind, si dhe të drejta shtesë pensioni, përbënte njohje për punën sfiduese të kryer

nga nëpunësit e burgjeve dhe kishte për qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e kandidatëve të kualifikuar për të punuar në burgje.

ç. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar

Ligji ndalon arrestimin dhe paraburgimin arbitrar dhe parashikon të drejtën e çdo personi për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose paraburgimit në gjykatë. Qeveria në përgjithësi i respektoi këto detyrime.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të burgosurve

Ligji parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalim të të dyshuarve bazuar në prova, kurse policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji ia ndalon policisë marrjen në pyetje të të dyshuarve pa i informuar ata për statusin dhe të drejtat e tyre dhe pa ua mundësuar të marrin një avokat. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbajtur këtyre procedurave. Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë. Pas aktakuzës, paraburgimi mund të zgjasë maksimumi dy vjet.

Ekziston sistem funksional i dorëzanisë. Përveç dorëzanisë, ligji lejon zëvendësimin e paraburgimit me arrest shtëpie apo masa të tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurve në gjyq. Masat e zakonshme përfshijnë sekuestrimin e pasaportës, ndalim për t'u larguar nga vendi i banimit dhe detyrim për t'u paraqitur në gjykatë një herë në javë.

Ligji i lejon të pandehurit të komunikojnë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por nganjëherë të pandehurit ankohen se autoritetet nuk ofrojnë kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar me avokatin përpara ngritjes së akuzës. Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë të drejtë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim. Ligji parashikon afate këshilluese për të shmangur procedimet e zgjatura penale. Prokurorët përgjithësisht duhet të përfundojnë hetimet brenda gjashtë muajve, megjithëse afatet mund të zgjaten në 12 muaj në raste më komplekse dhe 18 muaj në raste të krimit të organizuar me pëlqimin e një mbikëqyrësi. Në praktikë,

prokurorët ndonjëherë i kapërcejnë këto afate duke përmendur mungesën e burimeve të duhura apo kompleksitetin e rasteve. Në prill, kryeprokurori publik udhëzoi prokurorët të shqyrtojnë rastet në të cilat janë tejkaluar afatet hetimore, të zgjidhin çdo çështje të pazgjidhur dhe të përmirësojnë bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e tjera.

Një raport i 25 qershorit nga Mekanizmi Parandalues Kombëtar i Avokatit të Popullit deklaroi se nga janari deri në shtator 2020, vetëm 15 nga 1,080 personat e arrestuar ushtruan të drejtën e tyre për një avokat me shpenzime publike. Raporti nxori përfundimin se policët pothuajse kurrë nuk i këshilluan të arrestuarit se personat skamnorë kishin të drejtë të kërkonin një avokat falas dhe se shumë stacione policore përdornin lista të vjetruara të avokatëve, disa nga ato ishin nga viti 2012. Stacionet e policisë të vizituara nga Avokati i Popullit gjithashtu nuk kishin lista të përditësuara të avokatëve mbrojtës që kishin përfunduar trajnimin e specializuar të drejtësisë për të miturit.

Përveç hetimit të çdo pretendimi për keqtrajtim policor, SSP i Ministrisë së Brendshme kreu të gjitha hetimet e brendshme për pretendimet e formave të tjera të sjelljes së keqe të policisë. Sektori ka autorizim të shqiptojë sanksione administrative, si pezullim i përkohshëm nga puna, gjatë zhvillimit të hetimeve. Sektori nuk mund të marrë masa disiplinore, të cilat kërkojnë një vendim nga një komision disiplinor, as nuk mund të vendosë sanksione penale më të rënda, të cilat kërkojnë veprim të prokurorisë, por mund të referojë rastet sipas nevojës.

Deri më 27 gusht, ZPKOK kishte hetuar 68 raste të sjelljes së keqe nga policët e identifikuar dhe rojet e burgut, duke përfshirë një për arrestim të paligjshëm. Ajo hetoi gjithashtu 19 raste të tjera që dyshohet se përfshijnë sjellje të keqe kriminale nga policë të paidentifikuar apo roje burgu dhe shqyrtoi 115 ankesa të tjera penale.

Paraburgim në pritje të gjykimit: Në shumicën e rasteve, gjykatat kanë respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit. Prokurorët në të gjithë vendin kishin kërkuar paraburgim në 5 deri në 10 për qind të të gjitha rasteve. Zakonisht, prokurorët kishin kërkuar, dhe gjykatat kishin vendosur masa parandaluese në vend të urdhrave për paraburgim të të dyshuarve dhe të pandehurve për të parandaluar rrezikun e arratisjes së dëshmitarëve, manipulimit të provave dhe përsëritjen ose kryerjen e krimeve të reja.

d. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom. Rastet e sjelljes së keqe gjyqësore, presioni i panevojshëm mbi gjykatësit, drejtësia e zgjatur dhe fondet e papërshtatshme dhe personeli i gjyqësorit vazhduan të pengojnë operacionet dhe efektivitetin e gjykatës dhe cenuan besimin e publikut në gjyqësor. Gjykatat vazhduan të funksionojnë gjatë gjithë pandemisë së KOVID-19, por me reduktim të gjykimeve dhe vonesa të konsiderueshme. Si gjyqësori ashtu edhe Zyra e Prokurorisë Publike kishin më pak mjete financiare dhe të punësuar. Më 15 shtator, kryetari i Këshillit Gjyqësor tha se mungesa e përgjithshme e personelit si të gjyqtarëve ashtu edhe të personelit mbështetës ndikoi në administrimin e efektshëm të drejtësisë. Deri më 30 gushti, Gjykata e Lartë punoi me 18 nga 28 gjyqtarë, që rezultoi me ngarkesë më të mëdha pune, veçanërisht për gjyqtarët nga Njësia e Çështjeve Penale të gjykatës.

Një analizë funksionale nga një organizatë joqeveritare (OJQ) konstatoi se Zyra e Prokurorit Publik funksiononte me 20 për qind më pak prokurorë dhe 31 për qind më pak staf administrativ krahasuar me vlerësimin e nevojave të saj. Në raportin e progresit të vitit 2020 për vendin, BE-ja vërejti "një rënie prej 15 përqind të mjeteve të ndara për Zyrën e Prokurorit Publik me buxhetin shtetëror të vitit 2020". Ligji detyron që të paktën 0.4 për qind e buxhetit të shtetit të ndahet për buxhetin e prokurorëve.

Deri më 31 gusht, Këshilli Gjyqësor kishte marrë 479 ankesa të qytetarëve për pretendime në lidhje me probleme në procedurë gjyqësore. Pretendimet përfshinin sjellje të dyshuara paragjykuese ose joetike, gabime procedurale, rikthime të lëndëve dhe tejkalim afatesh. Deri më 5 nëntor, Këshilli Gjyqësor nuk kishte marrë ndonjë ankesë nga gjyqtarët që pretendonin kërcënime apo presion lidhur me rastin.

Deri në 20 gusht, Avokati i Popullit kishte regjistruar 187 ankesa të shtetasve lidhur me sistemin gjyqësor, nga të cilat 133 kishin të bënin me procedimet përpara gjykatave dhe 54 përpara Zyrës së Prokurorit Publik. Kjo përbënte një rritje krahasuar me vitin 2020. Shumica e ankesave në lidhje me procedurat para gjykatave përmbanin pretendime për privimin e të drejtës për një gjykim të drejtë nga vonesat e përsëritura të gjykimit, anshmërinë gjyqësore ose sjelljet e gabuara, shkeljet e procesit të rregullt ligjor, mohimin e qasjes në rekurs efektiv ligjor dhe dështimet për të reaguar ndaj zbulimit. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave, Avokati i Popullit konstatoi se shumica nuk meritonte shqyrtim të mëtejshëm. Në një rast, Avokati i Popullit konstatoi një shkelje të së drejtës për gjykim në një kohë të arsyeshme

përpara Gjykatës Administrative dhe këshilloi gjykatën të ndërmarrë veprime korrigjuese. Shumica e ankesave në lidhje me procedurat përpara Zyrës së Prokurorit Publik pretendojnë hetime të zgjatura, moskomunikim të statusit të rasteve ndaj palëve të interesuara dhe pakënaqësi me rezultatet e rasteve. Pas shqyrtimit të ankesave, zyra e Avokatit të Popullit konstatoi se i mungonte autoriteti për të shqyrtuar shumë nga pretendimet dhe shpesh nuk ishte në gjendje të identifikonte ndonjë shkelje të të drejtave.

Në dhjetor 2020, Këshilli Gjyqësor miratoi metodologjitë për rishikimin e punës së gjyqtarëve, të njohura edhe si "metodologjitë e filtrimit gjyqësor". Sipas kryetarit të atëhershëm të Këshillit Gjyqësor dhe gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Kiro Zdravev, metodologjitë dhanë një kornizë veprimi dhe afat kohor për zbatimin e autoritetit ligjor ekzistues të Këshillit Gjyqësor në vend të futjes së një mekanizmi të ri vlerësimi për të zëvendësuar ciklet e rregullta katër-vjeçare të vlerësimit të punës së gjyqtarëve. Metodologjitë e reja të filtrimit ofrojnë udhëzime specifike për shqyrtimin e arsyeve subjektive dhe objektive për vonesën e çështjeve, vjetërsimin e çështjes për shkak të afati të skaduar të parashkrimit, cilësinë e opinioneve gjyqësore, përfshirë arsyetimin cilësor ose mungesën e tij, kujdesin e duhur, praktikat e shpërblimit, ndër të tjera.

Më 28 shtator, OJQ-ja Të Gjithë për Gjykime të Ndershme lëshoi një raport analitik mbi operacionet e Këshillit Gjyqësor, sipas të cilit disa gjyqtarë raportuan se këshilli nuk kishte përfaqësuar, promovuar ose mbrojtur siç duhet, interesat e tyre apo pavarësinë gjyqësore në përgjithësi. Raporti zbuloi gjithashtu perceptimin se Këshillit Gjyqësor i mungonte transparenca. Të intervistuarit përmendën posaçërisht mungesën e arsyetimit publik për të justifikuar vendimet e këshillit për emërimin, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

Prej në janar deri gusht 2019, Këshilli Gjyqësor hodhi poshtë pesë justifikime të Gjykatës së Lartë, kryesisht për sjellje të keqe që përfshinin shqyrtimin e rasteve të ish-Prokurorisë së Posaçme. Gjatë së njëjtës periudhë, këshilli shkarkoi gjithashtu një duzinë gjyqtarësh të tjerë të apelit dhe gjyqit për sjellje të keqe që përfshinin punë gjyqësore joprofesionale dhe të pakujdesshme. Shtatë shkarkime ndodhën gjatë vitit. Shumë prej tyre janë mbështetur nga panelet e apelit të Gjykatës së Lartë, por një panel ktheu mbrapsht shkarkimet e korrikut të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë dhe dy gjyqtarëve të gjykatës së apelit në vendimet e lëshuara në fund të nëntorit dhe fillim të dhjetorit. Këshilli Gjyqësor do të rishqyrtojë rastet e tyre.

Procedurat e gjykimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe gjyqësori në përgjithësi e ka zbatuar këtë të drejtë.

Ligji i prezumon të pandehurit të pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia me vendim të plotëfuqishëm. Të pandehurit kanë të drejtë të informohen menjëherë dhe në hollësi për akuzat kundër tyre, në një gjuhë që i pandehuri e kupton, dhe të pajisen me një avokat nëse nuk janë në gjendje të paguajnë. Nganjëherë të pandehurit janë ankuar për mungesën e kohës dhe mjediseve të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre. Të pandehurit kanë të drejtë për gjykim të drejtë, në kohë dhe publik dhe të jenë të pranishëm në gjykimin e tyre, megjithëse ligji përfshin një përjashtim për gjykimin në mungesë të personit të arratisur. Të pandehurit kanë të drejtë të përballen me dëshmitarët e akuzës ose të paditësit dhe të paraqesin dëshmitë dhe provat e tyre. Ata mund të mos kenë nevojë të detyrohen të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë. Kanë të drejtë të ankohen.

Në përgjithësi, gjykimet kanë qenë të hapura për publikun. Qytetarët vazhduan të ankohen për praktika të pamjaftueshme të zbatimit, duke rezultuar në shkelje të të drejtave të qytetarëve.

Për shkak të pandemisë së KOVID-19, gjykatat kanë punuar me orare të reduktuara dhe ka pasur vonesa të shpeshta të shkaktuara nga palët, gjyqtarët dhe prokurorët që kishin testuar pozitiv për virusin ose iu desh të karantinoheshin pas ekspozimit.

Për disa raste penale dhe civile, janë përdorur panele gjyqësore prej tre deri pesë persona, të drejtuar nga një gjyqtar profesionist. Gjyqtarët porotë ndihmojnë në të gjitha rastet kur të pandehurit përballen me dënime të mundshme me burg me më shumë se pesë vjet. Përfshirja e tyre në raste ndonjëherë krijonte probleme, veçanërisht në rastet e dorëheqjes ose daljes në pension. Një rast kur një gjyqtar porotë u pensionua, së bashku me shkarkimin e një gjyqtari të karrierës në korrik, çoi në rifillimin e 20 gjykimeve, shumë prej të cilëve ishin në stade të avancuara dhe disa prej të cilëve përfshinin pretendime për korrupsion të lartë dhe ishin iniciuar nga ish-zyra e prokurorit special (ZPS). Gjatë vitit, gjyqet e profilit të lartë shpesh zgjateshin mbi baza të ndryshme procedurale apo të lidhura me shëndetin.

Më 23 shkurt, Gjykata Penale e Shkupit i shpalli fajtorë tre të pandehurit e rastit "Monstra" për terrorizëm, duke i dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e pesë maqedonasve etnikë në vitin 2012. Dy nga të pandehurit u gjykuan në mungesë si të

arratisur dhe besohej se ishin në Kosovë. Gjykata gjeti dy të pandehur të tjerë fajtorë për mungesë provash dhe e liroi të gjashtin. Në vitin 2014 Gjykata Themelore Penale e Shkupit fillimisht i dënoi të gjashtë të akuzuarit. Dënimet u rrëzuan në apel, duke bërë të domosdoshëm rigjykimin.

Më 26 korrik, Gjykata Penale e Shkupit lëshoi dënime me burg prej afërsisht gjashtë vjet për ish-kryetarin e parlamentit Trajko Veljanoski, ish-ministrin e arsimit Spiro Ristovski, ish-ministrin e transportit Mile Janakieski dhe ish-drejtorin e Administratës së Kundërzbulimit dhe Sigurisë Vlladimir Atanasovski, pasi i shpalli ata fajtorë për organizimin dhe nxitjen e dhunës në sulmin e dhunshëm në parlament në prill 2017. Akuzat e lidhura me to kundër ish kryeministrit Nikolla Gruevski dhe ish zyrtarit të kundërzbulimit Nikolla Boshkoski, të dy në arratisje, mbetën pezull. Prokurori i çështjes paralajmëroi apelimin kundër dënimeve duke i konsideruar shumë të butë pasi ishin nën minimumin e përshkruar të dënimit prej 10 vjetësh për këtë krim. Publiku ngriti pyetje rreth proporcionalitetit, duke krahasuar dënimet me shtatë deri në 18 vjet burg që u dhanë fillimisht për 16 të pandehur të dënuar për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në sulmin e vitit 2017.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime për të burgosur ose të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet gjyqësore civile

Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të njeriut. Individët mund të iniciojnë procedura për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, dhe në Gjykatën Kushtetuese, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga kryerësi i pretenduar. Individët mund të parashtrojnë ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe kjo është bazë ligjore për ngritjen e procedurave kundër vonesave të tepërta para Gjykatës Supreme. Qeveria përgjithësisht u pajtua me vendimet civile të gjykatave vendase. Individët mund të ankohen për rastet që përfshijnë shkeljet e pretenduara në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë e brendshme ligjore.

Grumbullimi i rasteve të mbetura në disa gjykata civil e dhe në Gjykatën Administrative vazhduan për shkak të pandemisë KOVID-19 dhe mungesës së

gjyqtarëve për shkak të daljes në pension dhe mungesës së aplikantëve të kualifikuar për pozicione gjyqësore.

Sekuestrimi dhe kthimi i pronave

Qeveria nuk dëboi personat nga vendet e tyre të banimit dhe as nuk sekuestroi pronat e tyre pa një proces të rregullt ligjor. Qeveria ka ligje dhe mekanizma në fuqi për shtetasit në vend. Qeveria nuk ka ligje apo mekanizma të posaçëm lidhur me zgjidhjen e pretendimeve të kohës së Holokaustit nga shtetasit e huaj, por ata ende mund të kërkojnë kthimin e pronave nëpërmjet procedimeve civile. Qeveria shënoi përparim të rëndësishëm në zgjidhjen e kërkesave të kthimit të pronës nga koha e Holokaustit për shtetasit, veçanërisht pas ligjit të denacionalizimit të vitit 2000 dhe marrëveshjes së kompensimit të vitit 2007.

Ligji për Denacionalizim i vitit 2000 i akordoi të drejtën e denacionalizimit të pasurisë së konfiskuar pas gushtit të vitit 1944 ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre, në përputhje me dispozitat lidhur me të drejtën e trashëgimit. Ai kërkon që aplikuesit të kenë shtetësinë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Grupet e avokimit kanë raportuar një numër se një numër i vogël shtetas të huaj, që nuk mbulohen nga ligji i vitit 2000, ende kërkonin kthimin e pronës. Shtetasit e huaj mund të aplikojnë për kthim në procedurat civile. Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut (BFI) vazhdoi të pretendojë se qeveria nuk arriti të sigurojë kthimin e duhur dhe në kohë të pronave të konfiskuara gjatë periudhës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, shpesh duke pretenduar se kjo ishte për shkak të vlerës së lartë të objekteve që pretendohej të jenë marrë. Midis pronës së kontestuar është Xhamia Husamedin Pasha në Shtip që u nacionalizua në vitin 1955. BFI pohoi se Qeveria ndërmori veprime deri në vitin 2019 që penguan BFI-në të rimarrë pronësinë e duhur të kompleksit të xhamisë. BFI vazhdoi gjithashtu të kërkojë kthimin e pronave në pazarin e vjetër të Shkupit.

Në prill Gjykata Kushtetuese kundërshtoi një peticion për të vendosur mbi kushtetutshmërinë e neni 64 të Ligjit të denacionalizimit pas shitjes së pronës nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve në qendër të Shkupit qendror që ishte subjekt i një procesi denacionalizimi që nga viti 2003.

Deri nga mesi i gushtit, Avokati i Popullit kishte marrë 28 ankesa në lidhje me denacionalizimin e pronës së konfiskuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, krahasuar me 14 në të njëjtën periudhë në vitin 2020 (27 në fund të

vitit). Avokati i Popullit vuri në dukje se kishte vështirësi të mëdha dhe mbikëqyrje procedurale në rastet e denacionalizimit dhe vonesat e shumta ia atribuoi pakujdesisë së Komisionit për Denacionalizim të Ministrisë së Financave, si dhe bashkëpunimit të paefektshëm me Gjykatën Administrative dhe agjenci të tjera qeveritare. Kjo situatë vazhdoi edhe pse Ligji i Denacionalizimit i vitit 2000 përcakton se procedura e denacionalizimit është urgjente sipas natyrës. Sipas Avokatit të Popullit, Komisioni i Denacionalizimit i Ministrisë së Financave ishte i paefektshëm në veprimin ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit për të trajtuar çështjet e pazgjidhura.

36 familje në Ohër protestuan disa herë gjatë vitit, edhe në qershor, duke pretenduar se autoritetet nuk i kishin kompensuar siç duhet ato për parcelat e tokës të nacionalizuar në vitin 1957.

Në shkurt, qeveria ndau afërsisht 707 milionë denarë (13.3 milionë dollarë) në obligacione për të kompensuar shtetasit, kërkesat e të cilëve për denacionalizim u miratuan në vitin 2019. Ajo ndau 492 milionë denarë shtesë (9 milionë dollarë) në gusht për qytetarët aplikimet e të cilëve u miratuan në vitin 2020.

Vendi është palë në Deklaratën e Terezinit të vitit 2009. raporti i Departamentit të Shtetit Justice for Uncompensated Survivors Today (JUST) Act për Kongresin, i bërë publik në korrik 2020, mund të gjendet në: https://www.state.gov/reports/just-act-report-to-congress/.

dh. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Ligji i ndalon këto veprime, dhe nuk ka pasur raporte që tregojnë se Qeveria nuk i ka respektuar këto ndalime gjatë vitit.

Ligji ndalon posedimin, përpunimin dhe botimin e çdo përmbajtjeje, duke përfshirë bisedat e përgjuara, që shkel të drejtën e privatësisë që përfshin jetën personale apo familjare. Ligji ndalon gjithashtu përdorimin e materialeve të tilla në fushatat zgjedhore apo për qëllime të tjera politike. Agjencia Teknike Operacionale është përgjegjëse për kryerjen e përgjimeve të ligjshme në vend. Shërben si lehtësues teknik i operacioneve për përgjimin ligjor të komunikimeve, duke vepruar me buxhetin e vet të posaçëm nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Megjithëse ekzistonte një Këshill për Mbikëqyrjen Civile të Përgjimit, ai nuk ishte funksional deri më 16 shtatori. Në qershor 2020, kryetari dhe nënkryetari i këshillit dhanë dorëheqjen, duke përmendur mungesën e burimeve për punë. Parlamenti miratoi dorëheqjet e tyre më 25 mars.

Më 26 shkurt, Gjykata Penale e Shkupit dënoi ish-drejtorin e Drejtorisë për Kundërzbulim dhe Siguri, Sasho Mijallkov dhe 10 bashkëpunëtorë të tij në gjyqin e mëparshëm të iniciuar nga ZPS "Target-Fortesa" për orkestrimin e përgjimit të paligjshëm të më shumë se 20,000 qytetarëve midis 2008 dhe 2015 dhe për shkatërrimin e provave. Gjykata e dënoi Mijallkovin me 12 vjet burg dhe e mbajti atë në paraburgim në pritje të apeleve. Ish-ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, e cila tashmë vuan dënimin me katër vjet burg në rastin "Tanku" të iniciuar nga ZPS, u dënua me katër vjet burg. Dy ish-punonjës të kundërzbulimit dhe të arratisurit e tanishëm, Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski, u dënuan në mungesë me 15 vjet burg.

Pjesa 2. Respektimi i lirive civile

a. Liria e shprehjes, duke përfshirë edhe punponjësit e shtypit dhe mediave të tjera

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes, duke përfshirë punonjësit e shtypit dhe mediave të tjera dhe qeveria përgjithësisht e respektoi këtë të drejtë. Sipas Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në vend, megjithatë, reagimi i organeve të zbatimit të ligjit dhe autoriteteve gjyqësore ndaj rasteve të dhunës së palës së tretë dhe frikësimit të gazetarëve ishte i ngadalshëm dhe i paefektshëm.

Deri më 20 shtatori, Zyra e Prokurorit Publik të Shkupit shqyrtoi 17 padi penale që pretendonin kërcënime dhe sulme fizike apo online kundër gazetarëve. Prokurorët konstatuan se tre nga këto ankesa meritonin hetime të mëtejshme të prokurorisë dhe tre u referuan në Ministrinë e Brendshme për t'u kualifikuar si kundërvajtje. 11 të tjerët nuk u morën për shqyrtim nga prokuroria për mungesë provash që vërtetojnë sjelljen kriminale.

Liria e shprehjes: Ligji ndalon gjuhën që nxit urrejtjen nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh ndëshkime për shkeljet. Individët mund të kritikojnë Qeverinë publikisht ose privatisht. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe aktivistë të tjerë të të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias raportuan një rritje të gjuhës së urrejtjes. Më 16 gusht, Komiteti lëshoi një njoftim për shtyp duke dënuar fyerjet dhe

nënçmimet ndaj mjekëve, të shprehura gjatë protestave kundër vaksinimit më 15 gusht në Shkup. Në një njoftim për shtyp, SHGM dënoi mesazhet vulgare dhe fyerjet kundër ekipeve të medias që mbuluan protestat.

Deri më 20 shtatori, Prokuroria Publike e Shkupit kishte shqyrtuar tetë ankesa penale që pretendonin sjellje të kriminalizuar si "përhapje të materialeve raciste dhe/ose ksenofobike përmes sistemit kompjuterik" sipas kodit penal. Prokurorët hodhën poshtë tre nga rastet dhe urdhëruan hetime të mëtejshme në pesë të tjera.

Liria e shprehjes për punonjësit e shtypit dhe mediat e tjera, si dhe mediat elektronike: Ndërsa media dhe raportimi ka mbetur thellësisht i ndarë përgjatë linjave politike, numri i mediave të pavarura që në mënyrë aktive kanë shprehur haptas vështrime të ndryshme ka vazhduar të rritet. Ligjet që ndalojnë gjuhën e cila nxit urrejtjen nacionale, fetare dhe etnike mbulojnë edhe shtypin dhe mediat elektronike, publikimin e librave, si dhe gazetat dhe revistat në internet.

Reklamimi i pushtetit qendrore në kanalet komerciale ndalohet, por reklamimi i pushtetit lokal lejohet. Shteti vazhdoi të subvencionojë mediat e shtypura. Fondet buxhetore u ndanë për mediat për të zbutur ndikimin e KOVID-19. Shteti subvencionoi reklamat politike të paguara në mediat komerciale për fushatën që shpuri në zgjedhjet lokale të 17 tetorit.

Më 1 prill, media njoftoi se më 31 mars, bazuar në raportet penale të policisë financiare, Zyra e Prokurorit Publik të Shkupit ngriti një padi përmbledhëse mbi akuzat e evazionit fiskal kundër një kompanie që thuhet se zotëron Alfa TV, një stacion televiziv komercial me mbulim kombëtar. Sipas akuzave, kompania iu shmang afërsisht 62.5 milion denarë (1.2 milion dollarë) në taksa mbi të ardhurat 2013/2014. Në një njoftim për shtyp të 19 majit, Alfa TV u ankua për presion nga policia financiare për hetimin e operacioneve financiare dhe të programit të stacionit në 2019 dhe 2020 dhe nga inspektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme për inspektimin e operacioneve tregtare të stacionit 2013-2020. Veprimet thuhet se u kryen në përputhje me urdhëratë e ZPKOK.

Në dhjetor 2020, pas një thirrjeje të hapur, qeveria ndau 30 milion denarë (rreth 570,000 $) për 11 media të shtypura për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për shtypje dhe shpërndarje për vitin 2020. Në përgjigje të një rekomandimi në Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion të Komisionit Shtetëror të Antikorrupsionit, që këshillon qeverinë të vendosë kritere më specifike subvencionuese për të

shmangur "shpenzimin jo të qëllimshëm të fondeve të dhëna", qeveria mandatoi përfituesit të paraqesin raportet e shpenzimeve në gjysmën e dytë të vitit.

Këshilli i Etikës së Medias vazhdoi të punojë për nxitjen e vetë-rregullimit. Deri më 25 gusht, këshilli kishte marrë 95 ankesa për raportim joetik dhe lajme të rreme, që ishte 10 përqind më i ulët se numri i marrë në të njëjtën periudhë të vitit 2020. Më shumë se 90 përqind e ankesave ishin të lidhura me raportime joetike. Më 5 mars, me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Maqedoninë e Veriut, këshilli lëshoi një sërë udhëzimesh etike për median online për të ndihmuar zhvillimin e vetë-rregullimit të besueshëm të medias online dhe për të forcuar raportimin e pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm. Me udhëzimet u kërkua pronësi transparente të medias online dhe caktimin e redaktorit(ve) që do të jetë përgjegjës për përmbajtjen e botuar, duke përfshirë atë nga palët e treta.

Dhuna dhe ngacmimi: Ka pasur disa raste të dhunës fizike, kërcënimeve dhe ngacmimeve të pretenduara ndaj gazetarëve gjatë vitit.

Deri më 27 gushti, SHGM regjistroi dy raste të sulmeve ndaj gazetarëve. Njëri ishte një sulm fizik kundër një kameramani të agjencisë shtetërore të lajmeve MIA nga protestuesit që merrnin pjesë në një protestë më 26 shkurt kundër vendimeve të gjykatës në gjyqin “Monstra”. Rasti tjetër kishte të bëjë me kërcënime të përsëritura me vdekje dhe përdhunim të bëra nga një person i identifikuar si Arben Esati në Facebook në mars kundër disa gazetarëve lokalë nga Tetova. Esati thuhet se ishte djali i një anesteziologu në pension nga Tetova që ofroi ndihmën e tij për presidentin e Serbisë për të luftuar pandeminë e KOVID-19. Pas një kërkese nga SHGM, policia ngriti padi penale kundër individit për kërcënim me dhunë dhe deri më 27 gusht, rasti ishte në pritje përpara Zyrës së Prokurorit Publik. SHGM mori 20 ankesa shtesë nga gazetarët lidhur me fyerjet e marra gjatë detyrës, sjelljen e papërshtatshme të zyrtarëve të pushtetit qendror dhe lokal ose anëtarëve të partive politike, si dhe mungesën e transparencës institucionale.

Gjykata Penale e Shkupit njoftoi se deri më 25 gushti ka pasur tre raste pezull që përfshinin gazetarët. Gjatë vitit Gjykata e Apelit e Shkupit mbështeti një vendim të Gjykatës Penale të Shkupit me të cilin u dënuan dy të pandehur me një vit e dy muaj secili dhe një tjetër i pandehur me tre vjet burg për pjesëmarrje në turmë të dhunshme që sulmoi dhe plagosi rëndë edhe një kameraman televizioni, gjatë protestave.

Tanja Milevska, një korrespondente e agjencisë shtetërore të lajmeve MIA me qendër në Bruksel, vazhdoi të marrë kërcënime me vdekje dhe përdhunim nga përdoruesit anonimë të Twitter dhe Facebook, të cilat ajo i denoncoi në polici në dhjetor të vitit 2020 dhe përsëri më 23 gusht. Deri më 25 gusht, kërkesa e Ministrisë së Brendshme për të kërkuar ndihmë ligjore ndërkombëtare për të marrë informacion nga platformat e mediave sociale ishte në pritje në Prokurorinë Publike të Shkupit.

Në dhjetor të vitit 2020 Gjykata Civile e Shkupit hodhi poshtë disa padi për kompensim civil të ngritura nga një grup gazetarësh dhe stafi i mediave në prill të vitit 2020, në të cilat ata kërkuan kompensim financiar dhe moral nga shteti për shkeljen e të drejtës së tyre për liri të fjalës në lidhje me sulmin e Parlamentit në prilli 2017. Gjykata hodhi poshtë paditë nga gazetarët Dushica Mrgja dhe Natasha Stojanovska, për mungesë provash.

Më 15 prill, Federata Evropiane e Gazetarëve iu bashkëngjit filialit të saj, SHGM, në një parashtresë që kundërshton vendimin e gjykatës më 2020 për të hedhur poshtë padinë e gazetarit Goran Tërpenoski në lidhje me këtë. Të dy organizatat pretenduan se vendimi shkeli standardet ligjore evropiane mbi lirinë e shtypit dhe i bënë thirrje gjykatës ta rishqyrtojë atë. Deri më 27 gusht, të tre rastet qenë në pritje të shqyrtimit përpara Gjykatës së Apelit të Shkupit dhe paditë lidhur me to nga katër gazetarë të tjerë ishin pezull përpara Gjykatës Civile të Shkupit.

Liria e internetit

Qeveria nuk kufizoi ose ndërpreu aksesin në internet apo censuroi përmbajtjen online dhe nuk pati raporte të besueshme se qeveria ka ndjekur komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor.

Qeveria nuk ka kufizuar ose penguar qasjen në internet ose censuruar përmbajtjet në internet. Nuk ka pasur raporte për vëzhgim qeveritar të komunikimeve private online pa autorizim përkatës ligjor.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Nuk ka pasur kufizime nga ana e qeverisë për lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit dhe shoqërimit paqësor

Ligji e parasheh lirinë e tubimit dhe shoqërimit paqësor dhe qeveria në përgjithësi i ka respektuar këto të drejta. Avokati i Popullit mori dy ankesa që pretendonin

shkelje të së drejtës për liri të tubimit dhe shoqërimit paqësor. Një ankesë përmbante pretendime se policët penguan protestuesit të marshonin përgjatë një rruge të autorizuar gjatë protestave të 26 shkurtit kundër verdiktit të gjyqit në rastin "Monstra". Ministria e Brendshme e këshilloi Avokatin e Popullit se masa disiplinore nuk mund të merrej për shkak të paaftësisë së ministrisë për të identifikuar policët e përfshirë. Ankesa tjetër përmbante pretendimin se policia ndërhyri në një protestë të 8 qershorit nga anëtarët e partisë politike VMRO-DPMNE duke arrestuar në mënyrë të paligjshme një protestues. Ministria e Brendshme mori masa disiplinore kundër një oficeri policie dhe e referoi rastin në ZPKOK për hetim të mëtejshëm.

c. Liria e besimit fetar

Shikoni Raportin e Departamentit të Shtetit mbi liritë fetare në botë në *International Religious Freedom Report* at https://www.state.gov/international-religious-freedom-reports/.

ç. Liria e lëvizjes dhe e drejta për t'u larguar nga vendi

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimet jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin dhe Qeveria përgjithësisht i ka respektuar këto të drejta.

"Gjendja e krizës" ka qenë në fuqi për zonat kufitare me Greqinë dhe Serbinë që nga gushti i vitit 2015. Ajo është zgjatur nga qeveria çdo gjashtë muaj, më së fundmi më 20 prill. Gjendja e krizës është në fuqi deri më 31 dhjetor. Gjendja e krizës i lejon qeverisë autoritete shtesë të rregullojë hyrjen dhe transitin e emigrantëve dhe të vendos për burime shtesë sipas nevojës. Që nga mbyllja e "rrugës së Ballkanit Perëndimor" në vitin 2016, emigrantët e kapur në këto zona ishin strehuar rregullisht në qendra transiti të përkohshme, pranë kufirit, dhe brenda disa ditësh u kthyen në vendin nga ku kishin hyrë. Nuk u sigurua liri e lëvizjes për migrantët ndërsa ishin në qendrat transite ose në qendrën e pritjes për të huajt e kontrabanduar, as nuk u krijua një procedurë zyrtare largimi ose ripranimi.

Me fillimin e pandemisë së KOVID-19, autoritetet caktuan Qendrën e përkohshme të Vinojug si një strukturë karantinimi për azil-kërkuesit, emigrantët me nevoja mjekësore dhe emigrantët e identifikuar si dëshmitarë në procedimet penale kundër kontrabandistëve me emigrantë. Përgjegjësia e përgjithshme për qendrat e tranzitit u nda midis Qendrës së Menaxhimit të Krizave, Ministrisë së Punës dhe Policisë

Kufitare, por statusi ligjor i qendrave të tranzitit Vinojug dhe Tabanoc nuk ishte përcaktuar deri më 15 shtator.

Nuk kishte mbikëqyrje gjyqësore lidhur me vendimin për të akomoduar migrantët dhe azil-kërkuesit në Qendrën Tranzite të Përkohshme Vinojug, e cila u bë një qendër e mbyllur, me personat e akomoduar atje të nënshtruar ndaj lirisë së kufizuar të lëvizjes për kohëzgjatjen e periudhës së karantinës së KOVID-19. Kur qeveria hoqi shumicën e kufizimeve për KOVID-19 lidhur me lirinë e lëvizjes, masat mbetën në fuqi për disa emigrantë dhe azil-kërkues.

Gjithsej 1,397 persona u akomoduan përkohësisht në qendrat transite në nëntë muajt e parë të vitit: 1,094 në Tabanoc, pranë kufirit me Serbinë dhe 303 në qendrën e transitit Vinojug, pranë kufirit me Greqinë.

Deri më 30 shtatori, vetëm 70 emigrantë mbetën në vend, duke përfshirë shtatë nga Afganistani, megjithëse afganët përfaqësonin numrin më të lartë të emigrantëve (më shumë se 40,000) që përpiqeshin të hynin nga Greqia. Emigrantët e tjerë shkuan drejt veriut përmes Serbisë ose u shtynë përsëri në Greqi.

Ligji parashikon se liria e lëvizjes mund të kufizohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ai lejon, për shembull, kufizimet e lëvizjes për të lejuar kohë për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e një individi, ose për të përcaktuar faktet dhe rrethanat e kërkesës së tij ose të saj për azil, veçanërisht në qoftë se është përcaktuar se ka rrezik që personi të largohet. Ligji lejon gjithashtu kufizime për të mbrojtur rendin dhe sigurinë kombëtare dhe kur një i huaj mbahet për qëllime të nisjes së një procedure për kthimin ose dëbimin e tij ose të saj.

Autoritetet nuk ushtruan presion mbi emigrantët për t'u kthyer në vendin e origjinës.

Avokati i Popullit konstatoi se Ministria e Brendshme ndonjëherë merrte vendime arbitrare për të kufizuar lirinë e lëvizjes, duke përfshirë rastet që përfshinin të mitur të pashoqëruar. Gjatë vitit Avokati i Popullit shqyrtoi dy raste që pretendonin lirinë e kufizuar të lëvizjes së dy të miturve të pashoqëruar, të dy shtetas të huaj.

Lëvizja në vend: Nuk ka pasur kufizime të lëvizjes në vend për banorët, as për ndonjë person nën mandatin e Komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR), edhe pse mungesa e dokumenteve personale të identifikimit (si karta e identifikimit, certifikata e lindjes, etj.) nga persona pa shtetësi shpesh i pengonte ata për të ushtruar të drejtën e lirisë së lëvizjes.

Dokumentet e Konventës të Udhëtimit (DKU) rregullohen me ligj; Megjithatë, formularët e DKU nuk janë të lexueshme nga makinat dhe për këtë arsye nuk përputhen me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Zyra e UNHCR-së në Shkup nuk ishte në dijeni për DKU-të që përdoreshin për udhëtim jashtë vendit.

Zyra e UNHCR-së në Shkup ka vlerësuar se rreth 14.000 persona kanë transituar në vend nga 1 janar - 31 gusht, por as UNHCR dhe as Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) nuk kanë regjistruar ndonjë vepër urrejtje kundër tyre. UNHCR nuk ka vërejtur ndonjë kufizim të lëvizjes brenda vendit për personat e zhvendosur (PZHV), refugjatët ose personat pa shtetësi. Sipas agjencisë së rojës kufitare dhe bregdetare të BE, Frontex, 22,600 emigrantë, shumica nga Siria dhe Afganistani, u vërejtën përgjatë të ashtuquajturës rrugë ballkanike që përfshin Maqedoninë e Veriut gjatë shtatë muajve të parë të vitit. Kjo ishte dyfishi i individëve që u hasën në të njëjtën periudhë në vitin 2020.

Shtetësia: Kërkesat për shtetësi të disa banorëve shqiptarë etnikë qenë në pritje të zgjidhjes. Disa romë supozoheshin ende të ishin jo-shtetas, pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të shtetit për të rregulluar statusin e tyre, sipas organizatave të shoqërisë civile (OSHQ-të). Vlerësimet ishin se rreth 800 romë nuk kishin shtetësi. Shumica e tyre nuk qenë në gjendje të merrnin shtetësinë në periudhën pas pavarësisë së vendit nga ish Jugosllavia, për shkak të analfabetizmit apo mungesës së ndërgjegjësimit për proceset e duhura burokratike. Rrjedhimisht, disa romë nuk qenë në gjendje të merrnin dokumente të reja kombëtare identifikimi apo të jepnin prova të banimit të kërkuar.

Avokati i Popullit mbikëqyr zbatimin e Ligjit mbi Shtetësinë, duke përfshirë amendamentet e miratuara në korrik, të parapara për të lehtësuar dhënien e shtetësisë personave pa dokumente që ishin banorë në vend përpara pavarësisë në vitin 1991. Avokati i Popullit mori 16 ankesa që pretendonin vonesa të pajustifikuara në kërkesat për shtetësi. Sipas tij, shumica e këtyre vonesave rezultuan nga vendimet "arbitrare dhe subjektive" të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë që zgjatën procedurat e verifikimit të sigurisë.

Ministria e Brendshme njoftoi se 71 banorë për një kohë të gjatë kishin aplikuar për shtetësi sipas dispozitave të ndryshuara të Ligjit për Shtetësi, deri më 30 shtator, 13 prej tyre ishin miratuar.

d. Statusi dhe trajtimi i personave të zhvendosur brenda vendit

Sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, deri më 30 shtatori, 109 persona nga 26 familje mbetën të zhvendosur nga konflikti i brendshëm i armatosur i vitit 2001. Prej tyre gjashtë persona nga tre familje jetonin në qendra kolektive banimi dhe 103 nga 23 familje jetonin në strehim privat ose me familje pritëse. Strehimi i përhershëm mbetet një problem për PZHBV-të, ndonëse qeveria mbulonte qiranë mujore.

Qeveria ka ofruar mbrojtje dhe asistencë dhe ka mbështetur kthimet e sigurta dhe vullnetare, si dhe rivendosjen dhe integrimin lokal të PZHBV-ve. Nuk pati raportime për PZHBV, viktima të abuzimeve.

Përkundër mungesës së një dokumenti të politikës kombëtare për PZHBV-të, Qeveria përgjithësisht ka respektuar Parimet Udhëzuese të OKB-së mbi Zhvendosjen e Brendshme. Më 5 janar, qeveria miratoi një Program të Mbrojtjes Sociale i cili udhëzoi Ministrinë e Punës të përqendrohej në programet e projektuara për të ndihmuar me kthimin e qëndrueshëm të PZHBV-ve në vendet e tyre të origjinës.

dh. Mbrojtja e refugjatëve

Qeveria ka bashkëpunuar me UNHCR, IOM dhe organizata të tjera humanitare në sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës për PZHVB-të, refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, migrantët, personat pa shtetësi, personat që u është dhënë mbrojtje dytësore dhe personat e tjerë të prekur.

Qasja tek azili: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilit apo refugjatëve dhe qeveria ka ngritur një sistem për sigurimin e mbrojtjes për refugjatët.

UNHCR vlerësoi se proceset e azilit vazhduan të përmirësohen dhe shqetësimet e mëparshme lidhur me një praktikë të mohimit arbitrar të qasjes tek azili ishin tejkaluar. UNHCR ka raportuar se mekanizmi për përcaktimin e statusit të refugjatëve nuk ka siguruar garanci themelore procedurale dhe përcaktim adekuat, siç parashihet me ligj.

Deri më 30 qershor, gjithsej 30 persona kishin aplikuar për azil. Askujt nuk iu dha mbrojtje ndërkombëtare gjatë vitit dhe askujt nuk i është dhënë statusi i refugjatit që nga viti 2016. Të gjitha kërkesat për azil të regjistruara në vend u përpunuan nëpërmjet Qendrës së Pritjes për të Huajt. Për shkak të rregulloreve të KOVID, të gjithë azil-kërkuesit fillimisht u vendosën në një karantinë dy-javore në Qendrën e e Përkohshme të transitit Vinojug para se të transferoheshin në qendrën e pritjes për

azil-kërkuesit në Shkup. Kuadri ligjor i vendit parashikon masa mbrojtëse proceduriale dhe shqyrtim gjatë procedurës së azilit.

Pati disa mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e disa masave mbrojtëse, duke përfshirë nivelin gjyqësor. Për shembull, edhe pse ligjërisht e lejueshme, në praktikë gjykata refuzoi të gjitha kërkesat të bëra nga azil-kërkuesit. Po kështu, gjykatat administrative vijuan të shmangin dhënien e vendimit për bazueshmërinë e kërkesave për azil, pavarësisht se kishin autoritetin e duhur. Në vend të kësaj, ata në mënyrë rutinore i kthyen rastet në Ministrinë e Brendshme për shqyrtim të mëtejshëm, ku ministria rikonfirmoi vendimin fillestar të saj.

Vazhdoi praktika e kthimit të emigrantëve të kapur në Maqedoninë e Veriut në vendin nga i cili kanë hyrë në Maqedoninë e Veriut. Autoritetet rifilluan shqyrtimin dhe regjistrimin e duhur të të gjithë emigrantëve që nga fundi i janarit pasi procesi ishte lënë pezull në mars 2020 për shkak të masave për Kovid.

UNHCR dhe organizatat partnere kishin qasje të kufizuar tek emigrantët e strehuar në dy qendrat e tranzitit të përkohshëm pranë kufirit. Informacioni rreth mbrojtjes nuk u ofrohej gjithmonë personave të vendosur në qendrat.

Qeveria u ka lëshuar dokumente të identifikimit të gjithë refugjatëve të njohur dhe personave tjerë nën mbrojtje subsidiare, por autoritetet shpesh ua kanë vonuar dokumentet e identifikimit azilkërkuesve të rinj. Pasi u lëshuan, këto dokumente identiteti shpesh nuk përmbanin numër personal identifikimi, i cili nga ana tjetër kufizonte qasjen e individëve në disa shërbime qeveritare, duke përfshirë qasjen në arsim dhe programet e mirëqenies sociale.

Vendi i sigurt i origjinës/tranzitit: Vendi miratoi një listë të vendeve të sigurta të origjinës, që përfshin të gjitha vendet anëtare të BE-së, vendet fqinje dhe disa vende të tjera, duke përfshirë Bosnje dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Turqinë, Rusinë, Egjiptin, Etiopinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Nepalin. Koncepti mbetet ende në pritje të zbatimit.

Abuzimi me emigrantët dhe refugjatët: Autoritetet morën masa për të luftuar dhe zbuluar rastet e kontrabandës dhe trafikimit të emigrantëve duke përdorur mbështetjen e ekipeve të lëvizshme dhe të një grupi pune të përbërë nga përfaqësues nga ministria e brendshme dhe prokurorë nga ZPKOK. Raporti i Komisionit Evropian i tetorit 2020 vuri në dukje se individët që kalojnë tranzit në vend pa

autorizim mbetën në shënjestër të grupeve të organizuara kriminale të angazhuara në kontrabandën e njerëzve, të cilët shpesh i zhvatën ose abuzuan me to.

Sipas UNHCR-së, ka pasur njoftime për dhunë kundër emigrantëve nga kontrabandistët apo personat e tjerë me të cilët ata po udhëtonin. Në disa raste kishte njoftime për roje kufitare që vepronin me dhunë ndaj emigrantëve.

Sipas Avokatit të Popullit, vendosja e emigrantëve në Qendrën e Tranzitit Vinojug pa nxjerrë vendime me shkrim të mbajtjes ishte një problem sepse me këtë u kufizua liria e lëvizjes së këtyre personave pa dokumentuar siç duhet çdo rast. Avokati i Popullit përmendi se shumica e emigrantëve të vendosur në qendrën e transitit thjesht mbaheshin atje për të siguruar dëshmitë e tyre në gjyqet kundër kontrabandistëve, bazuar në kërkesat dhe urdhrat me gojë nga prokurorët e rastit.

IOM theksoi se lëvizja e migrantëve përmes rrugës së Ballkanit Perëndimor u lehtësua nga rrjetet e kontrabandës, me çka migrantët u ekspozuan ndaj rreziqeve të konsiderueshme të abuzimit dhe praktikave shfrytëzuese, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore.

Pati raporte jo të rralla të incidenteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore nga kontrabandistët kundër emigrantëve. Shumica e emigrantëve në transit ishin burra të vetëm në moshë pune.

Autoritetet ofruan mekanizmat e duhur për të mbrojtur emigrantët, refugjatët, azil-kërkuesit dhe personat pa shtetësi nga abuzimi. Një sistem shumë-sektorësh dhe procedurat standarde të operimit (PSO) u krijuan për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për individët e cenueshëm nga dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë PSO-të për Përpunimin e Kategorive të Prekshme të Shtetasve të Huaj, PSO-të për Trajtimin e Fëmijëve të Pashoqëruar dhe të Ndarë, dhe PSO-të për Trajtimin e Viktimave të Trafikimit. UNHCR theksoi se sistemi kishte nevojë për forcim dhe një zbatim sistematik të PSO-ve, veçanërisht në lidhje me identifikimin e rasteve.

Liria e lëvizjes. Sipas UNHCR, autoritetet vazhduan të arrestojnë individë të kapur ndërsa udhëtonin nëpër vend pa dokumentacion. Bazat për vendimet e paraburgimit ishin arbitrare. Si rregull, individët duhet të mbahen në paraburgim vetëm derisa të mund të përcaktohet identiteti i tyre. Megjithatë, ata rregullisht janë mbajtur edhe pas identifikimit, për t'i penguar që të arratiseshin nga vendi para se të jepnin dëshmi në gjykatë kundër kontrabanduesve.

Periudha mesatare e ndalimit të azilkërkuesve gjatë vitit ishte 15 ditë, me periudhën më të gjatë 45 ditë dhe periudhën më të shkurtër një ditë.

Punësimi: Nuk ka kufizime në mundësinë e refugjatëve për të punuar dhe ligji lejon azilkërkuesit, të cilët nuk kanë përfunduar procedurat e azilit brenda nëntë muajve të aplikojnë për leje pune.

Refugjatët e njohur dhe personat nën mbrojtje subsidiare me leje pune kanë mundësinë të hyjnë në tregun aktiv të punës. Megjithatë, azilkërkuesit u përballën me kufizime për shkak të ligjeve në kundërshtim. Refugjatët u ndeshën gjithashtu me vështirësi praktike, siç janë pengesat gjuhësore dhe mungesa e procedurave për njohjen e aftësive apo vërtetimin e diplomave të huaja. Me ligj, një i huaj duhet të ketë një numër unik identifikimi të caktuar për t'u pajisur me leje pune. Megjithëse një azilkërkues ka të drejtë ligjore të aplikojë për leje pune nëntë muaj pas aplikimit për azil, nuk ka të drejtë të marrë një numër unik identifikimi derisa të fitojë azilin. Rrjedhimisht, azilkërkuesi ka të drejtë të punojë, por nuk është në gjendje ta ushtrojë atë të drejtë. Kjo përbën një boshllëk serioz në mbrojtje pasi rastet nganjëherë mbeten pezull për dy deri në tre vjet.

Qasja në shërbimet themelore: Azilkërkuesit kishin të drejtë për shërbime shëndetësore bazë ndërsa kërkesat e tyre ishin në pritje. E njëjta gjë vlente për të drejtën për arsim. Refugjatët kanë të drejtën e kujdesit të plotë shëndetësor që u ofrohet me të njëjtat kushte shtetasve në vend.

Zgjidhje të qëndrueshme: Ligji parashikon natyralizimin e refugjatëve që banojnë në vend me kushte preferenciale. Personat nën mbrojtje subsidiare mund të natyralizohen pas tetë vjet qëndrimi të ligjshëm në vend. Gjatë vitit, u natyralizuan një refugjat dhe një person nën mbrojtje subsidiare. Vendi nuk lejon që fëmijët të marrin automatikisht shtetësinë e Maqedonisë së Veriut në lindje nëse ata janë gjithashtu shtetas të një vendi tjetër.

Me ligj, Ministria e Punës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe UNHCR, duhet të lehtësojë kthimin vullnetar të azilkërkuesve në vendet e tyre. Nuk ka pasur raste të riatdhesimit vullnetar të asistuar gjatë vitit.

Gjatë vitit asnjë nga mbi 200 personat që mbetën në vend nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë nuk u kthyen në Kosovë me ndihmën e UNHCR.

UNHCR edhe më tej i ka ndihmuar azilkërkuesit nga Kosova të cilët janë refuzuar dhe që u është lejuar të qëndrojnë në vend. Qeveria u ka lëshuar atyre dokumente të përkohshme identifikimi, për t'ua siguruar qasjen deri te shërbimet. Ministria e Punës ka siguruar zgjidhje të integruara dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e UNHCR-së për rreth 274 refugjatë që kanë aplikuar për integrim në vend. Ministria ka siguruar ndihmë sociale, ndihmë strehimi dhe akses në arsim, kujdes shëndetësor dhe në tregun e punës.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria mund të sigurojë mbrojtje subsidiare për individët që mund të mos kualifikohen si refugjatë. Deri më 30 shtatori, një personi iu dha mbrojtje subsidiare.

e. Personat pa shtetësi

Vendit i mungon një sistem gjithëpërfshirës zyrtar për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave mbi numrin e personave pa shtetësi në territorin e tij. Regjistrimi i vitit 2002 nxori 17.652 individë "pa shtetësi". Një regjistrim i ri u krye në shtator dhe rezultatet përfundimtare priten në vitin 2022. Disa banorë mbetën ligjërisht pa shtetësi. Sipas statistikave të konsoliduara nga qeveria, UNHCR dhe OJQ-të, kishte 554 persona pa shtetësi të regjistruar në vend në fund të korrikut. Fëmijët e lindur në vend të personave pa shtetësi kanë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin certifikatë. Ata konsiderohen shtetas të huaj, me kusht që të banojnë ligjërisht ose përgjithmonë në vend për të paktën gjashtë vjet.

Një program qeveritar për të regjistruar personat pa dokumente filloi në fund të vitit 2018. Në shkurt 2020 parlamenti miratoi një ligj të përkohshëm për të lehtësuar regjistrimin e tyre në Regjistrin e Lindjeve. Më 3 qershor, zëvendës - Avokati i Popullit tha se zbatimi i ligjit ishte joadekuat, për shkak të një sërë pengesash praktike dhe rekomandoi që ligji i përkohshëm, i cili ishte vendosur të përfundonte më 30 qershor, të shtyhej për një vit tjetër. Sipas zëvendës Avokatit të Popullit, që nga prilli, 70 përqind e personave të paregjistruar të identifikuar nuk kishin aplikuar ende për regjistrim; 659 individë kishin aplikuar, nga të cilët 397 (60 përqind) ishin fëmijë dhe ishin futur në Regjistrin e Lindjeve. Ministria e Punës vlerësoi se shumica e individëve që u mungonte regjistrimi civil dhe dokumentacioni ishin fëmijë romë në rrezik të mbeten pa shtetësi.

Më 29 korrik, parlamenti ndryshoi Ligjin mbi Shtetësinë për t'u siguruar banorëve për një kohë të gjatë shtigje shtesë për të marrë shtetësinë. Amendamentet u bënë

pasi partitë shqiptare etnike të opozitës pretenduan se më shumë se 7,000 banorëve shqiptarë në vend u ishte mohuar padrejtësisht e drejta për të marrë shtetësinë.

Një OJQ lokale, Shoqata e Avokatëve të Rinj Maqedonas, kritikoi se Ligji ishte miratuar në "mënyrë jo transparente." OJQ-ja e karakterizoi më tej ligjin si të papërshtatshëm për të zgjidhur problemin e personave pa shtetësi, duke vënë në dukje se ai i vendoste personat me shtetësi të një vendi tjetër në një pozitë më të favorshme në krahasim me personat pa shtetësi.

Pavarësisht nga mbrojtjet bazë kundër ndalimit arbitrar dhe disa masave mbrojtëse për të parandaluar dhe zvogëluar pashtetësinë, nuk ka mekanizëm për të identifikuar dhe përcaktuar pashtetësinë në vend, nuk ka status të mbrojtjes së personave pa shtetësi dhe as ndonjë rrugë për marrjen e shtetësisë për personat pa shtetësi. Mbetën mangësi të konsiderueshme, të cilat penguan përparimin e vendit drejt përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e personave pa shtetësi dhe parandalimin e pashtetësisë. Pengesat për regjistrimin e përgjithshëm të lindjes dhe atë civil vazhduan të prekin në mënyrë joproporcionale grupet e pakicave, duke përfshirë romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët ballkanas.

Personat pa shtetësi nuk mund të përfitonin nga punësimi i ligjshëm dhe nuk kishin akses në gjykata apo shërbime qeveritare. Nuk ka pasur raporte të dhunës fizike ndaj personave pa shtetësi për shkak të mungesës së dokumenteve të identitetit, por ata nuk kishin qasje në vaksinimin kundër KOVID-19 ose ndonjë të drejtë për të cilën kërkohet një dokument identiteti dhe një numër personal identifikimi (p.sh., sigurimi shëndetësor, arsimi, ndihma sociale, etj.).

Pjesa 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik

Ligji iu ofron shtetasve mundësinë për të zgjedhur qeverinë në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta të mbajtura me votim të fshehtë dhe në zgjedhje të përgjithshme dhe të barabarta.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u mbajtën në korrik 2020. OSBE/ODIHR-it në raportin e tij thotë, "Zgjedhjet e parakohshme parlamentare përgjithësisht u administruan në mënyrë efektive, me përshtatje në përgjigje të pandemisë KOVID-19, por stabiliteti ligjor u dëmtua nga rishikimet

thelbësore të Kodit Zgjedhor dhe rregulloreve të mëvonshme *ad hoc* të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme." Në vazhdim të raportit thuhet se "fushata, megjithëse me ton negativ, ishte me të vërtetë garuese dhe pjesëmarrësit mund të përcillnin mesazhet e tyre pavarësisht kufizimeve në shtrirjen tradicionale" dhe "dita e zgjedhjeve rrodhi pa probleme, pavarësisht sfidave teknike në publikimin e rezultateve dhe shqetësimeve në lidhje me regjistrimin e votuesve." Zgjedhjet e përgjithshme për president u mbajtën në dy raunde në prill dhe maj 2019. Stevo Pendarovski fitoi zgjedhjet. Sipas raportit të OSBE / ODIHR mbi zgjedhjet " administrimi i mirë i [raundit të dytë] të zgjedhjeve presidenciale, respektimi i vazhdueshëm i lirive themelore u mundësoi votuesve të bënin një zgjedhje të informuar midis kandidatëve." Raporti gjithashtu vuri në dukje mangësitë në rregullat e fushatës që reflekton mangësi më të gjera në Kodin Zgjedhor dhe mungonte transparenca e financimit të fushatës për shkak të raportimit jo të plotë.

Më 7 gusht, Komisioni për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen Kundër Diskriminimit konstatoi se Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve diskriminoi 1,218 shtetas të rinj gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2019. Këta individë mbushën 18 vjet moshë midis raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve por nuk u lejuan të votojnë gjatë raundit të dytë.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Ka disa kufizime në themelimin ose anëtarësimin në partitë politike, të cilat i nënshtrohen ligjeve të njëjta si çdo qytetar i zakonshëm. Ndërsa anëtarësimi në një parti politike nuk është i detyrueshëm, ka një sistem aktiv në vend ku partitë ofrojnë përfitime dhe avantazhe të veçanta për anëtarët e tyre. Partia opozitare VMRO-DPMNE akuzoi qeverinë për vazhdimin e këtyre praktikave, duke pretenduar se nuk janë ndjekur kualifikimet arsimore dhe profesionale të përcaktuara me ligj për pozitat e administratës publike.

Pjesëmarrja e grave dhe pjesëtarëve të minoriteteve: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe pjesëtarëve të minoriteteve në procesin politik, dhe gratë dhe minoritetet kanë marrë pjesë në të. Me ligj, listat e kandidatëve të secilës parti politike për zgjedhjet parlamentar dhe lokale duhet të kenë shumëllojshmëri gjinore. Të paktën 40 përqind e kandidatëve të një partie duhet të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar. Deri më 4 nëntor, gjithsej 49 nga 120 deputetët kanë qenë gra dhe katër gra ishini ministre në kabinetin 20-anëtarësh të kryeministrit. Dy nga 81 kryetarë të komunave ishin gra.

Pjesëtarët e grupeve më të vogla të minoriteteve etnike vazhduan të ankohen për përfaqësim jo të drejtë brenda qeverisë dhe praktika diskriminuese që i përjashtonin ata nga pjesëmarrja politike. Në kabinetin qeveritar prej 20 anëtarësh, tetë ishin ministra shqiptarë. Deri më 1 nëntor, kishte 32 deputetë shqiptarë etnikë në parlament, duke përfshirë kryetarin e parlamentit dhe tre turq, dy serbë, një rom, një vlleh, një boshnjak dhe një hebre.

Avokati i Popullit njoftoi për disa përmirësime në përfaqësimin e barabartë të komuniteteve më të vogla etnike jo shumicë në radhët e administratës publike por jo në nivelin udhëheqës. Përjashtim qenë shqiptarët, komuniteti më i madh jo-shumicë, që morën pjesë në qeveri në nivel të ministrave.

Pjesa 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parasheh ndjekje penale për korrupsionin e zyrtarëve. Qeveria në përgjithësi ka zbatuar ligjin, ndonëse ka pasur raporte për zyrtarë të përfshirë në korrupsion. OJQ-të kanë theksuar rolin dominues të Qeverisë në ekonomi që ka krijuar mundësitë për korrupsion. Qeveria ishte punëdhënësi më i madh i vendit. Sipas Ministrit të Shoqërisë Informatike dhe Administratës, deri në fund të dhjetorit 2020, kishte 131.183 persona të punësuar në sektorin publik. Më parë, disa persona në listën e pagave të qeverisë nuk kishin vend pune të vërtetë. Më 19 janar, qeveria miratoi një plan për shpërndarjen e 1,349 punonjësve civilë të paguar nga Ministria e Sistemeve Politike dhe Marrëdhënieve me Komunitetet – të cilët në atë kohë nuk kishin një vend pune të vërtetë– në vende të posaçme pune në 237 institucione qeveritare. Më 27 prill, qeveria shkarkoi drejtorin e Inspektoratit Shtetëror të Tregut, Stojko Paunovski, sepse kishte refuzuar të zbatojë vendimin e qeverisë për pranimin e 35 punonjësve civilë në institucionin e tij.

Më 18 prill, parlamenti miratoi Strategjinë Kombëtare 2021-2025 për Luftën kundër Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, së bashku me planin e veprimit zbatues. Më 14 korrik, qeveria miratoi një Strategji Kombëtare 2021-2023 për Forcimin e Kapaciteteve për Hetimet Financiare dhe Konfiskimin e Pronës si pjesë e planit të saj për luftën kundër korrupsionit dhe parashikoi një komision për të monitoruar zbatimin e strategjisë.

Korrupsioni: Më 15 korrik, kryetarja e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (KSHPK), Biljana Ivanovska, deklaroi se pavarësisht nga perceptimi në rritje i korrupsionit në gjyqësor, vetëm 20 përqind e

ankesave të paraqitura në KSHPK përfshinin gjyqësorin, duke vënë në dukje dallimin midis perceptimit dhe realitetit.

Më 13 prill, si pjesë e rastit "Thesari" të iniciuar nga ZPS, Gjykata Penale e Shkupit dënoi ish-drejtorin e Drejtorisë për Kundërzbulim dhe Siguri, Sasho Mijallkov, si dhe tre ish-bashkëpunëtorë, për shpërdorim të detyrës që përfshin blerjen mashtruese të pajisjeve të mbikëqyrjes nga një kompani me seli në Mbretërinë e Bashkuar, me një ryshfet prej afro 52 milionë denarë (996,000 dollarë). Paratë u shpërndanë nëpërmjet Finzi, një kompani në pronësi të bashkëpunëtorit të atëhershëm të Mijallkovit, Orce Kamçev, i cili ishte në atë kohë në paraburgim lidhur me një gjykim tjetër penal. Gjykata e dënoi Mijallkovin me tetë vite burg dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij, pasi konstatoi se kishte rrezik që ai të arratisej. Gjykata lëshoi gjithashtu një urdhër konfiskimi të pasurisë prej rreth 37 milion denarë (703,000 $) kundër të pandehurve dhe një urdhër konfiskimi të një makine, prej rreth 9.8 milion denarë (190,000 $) kundër kompanisë të Kamçevit, Finzi, që tashmë nuk ishte aktive.

Më 16 prill, policia arrestoi ish këshilltarin e kabinetit të kryeministrit dhe sekretarin e përgjithshëm të qeverisë, Dragi Rashkovski. Rashkovski u arrestua pas një hetimi të ZPKOK rreth një prokurimi mashtrues të softuerit të mbikëqyrjes së trafikut për Ministrinë e Brendshme. Rashkovski paraqiti dorëheqjen e tij më 12 prill dhe u vendos në arrest shtëpiak. ZPKOK paditi Rashkovskin dhe gjashtë të tjerë për shpërdorim të detyrës dhe autoritetit zyrtar dhe pastrim parash për manipulimin e prokurimeve publike të katër zgjidhjeve softuerike midis 2017 dhe 2021 dhe ekzekutimin e transaksioneve financiare që synojnë të fshehin të ardhurat kriminale. Deri më 15 nëntori, padia ishte në pritje të konfirmimit përpara një trupi prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Penale të Shkupit për të vazhduar me gjyqin. Më 23 korrik, policia e burgut e transferoi ish-kryeprokuroren speciale Katica Janeva nga arresti shtëpiak në burgun e Idrizovës në Shkup pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Shkupit me të cilin mbështeti vendimin e saj të vitit 2019 në rastin "Zhvatje". Janeva u dënua me shtatë vjet burg për shpërdorim të funksionit zyrtar kur ishte prokurore e posaçme dhe e ngarkuar me ndjekjen penale të korrupsionit të lartë. I akuzuari kryesor i procesit "Zhvatje", Bojan Jovanovski (alias Boki 13), u transferua në burg për të vuajtur dënimin e tij me nëntë vjet burg më 22 korrik.

Pjesa 5. Qëndrimi qeveritar drejt hetimit ndërkombëtar dhe joqeveritar të abuzimeve të dyshuara me të drejtat e njeriut

Të drejtat

Grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përgjithësi kanë vepruar pa kufizime nga qeveria dhe i kanë hetuar dhe publikuar gjetjet e tyre mbi të drejtat e njeriut. Zyrtarët qeveritarë ishin treguar të gatshëm për t'i dëgjuar këto grupe por ngandonjëherë nuk kanë reaguar ndaj vështrimeve të tyre. Gjatë vitit disa ministri organizuan takime me grupe të punës që përfshinin anëtarë të shoqërisë civile.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (i njohur edhe si Komisioni Antidiskriminim) punuan për të mbrojtur qytetarët nga shkelja e të drejtave të tyre nga institucionet publike, për të zvogëluar diskriminimin ndaj komuniteteve pakicë dhe personave me aftësi të kufizuara, për të promovuar përfaqësimin e barabartë në jetën publike dhe për të adresuar abuzimet e të drejtave të fëmijëve.

Deri më15 gusht, Komisioni i Antidiskriminimit mori 108 ankesa me pretendime për diskriminim. Një shqyrtim fillestar i ankesave tregoi se tre kishin të bënin me arsimin, 18 me të drejtën e besimit politik, pesë me seksin dhe gjininë, 21 me statusin personal ose social, një me orientimin seksual, një me paaftësinë dhe një me moshën. Në disa ankesa u përmend edhe ndërsekcionaliteti si bazë.

Pjesa 6. Diskriminimi dhe abuzimet shoqërore

Gratë

Dhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi i burrave dhe grave, përfshirë edhe përdhunimi bashkëshortor është i kundërligjshëm. Dënimet për përdhunim lëvizin prej një deri në 15 vite burg, por ka zbatim të dobët të ligjit. Dhuna në familje është e paligjshme, por ka qenë një problem i vazhdueshëm dhe i përhapur. Dënimet lëvizin nga gjashtë muaj deri në pesë vjet burg për vepra penale më të lehta dhe një deri në 10 vjet burg për krime që rezultojnë me lëndime të rënda ose të përhershme trupore. Autorët mund të dënohen maksimalisht me burgim të përjetshëm nëse veprimet e tyre rezultojnë me vdekje të viktimës. Përveç kësaj, gjykatat mund të shqiptojnë gjoba. Ligji zbatohet në rastet kur viktimat denoncojnë rastin, por e shumta nuk e bëjnë këtë.

Në janar parlamenti miratoi Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje. Ligji ishte hartuar për të ndihmuar parandalimin dhe

mbrojtjen kundër dhunës me bazë gjinore dhe në familje dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të viktimave.

Nga janari deri në qershor, Ministria e Punës regjistroi 789 viktima të dhunës në familje, nga të cilat 530 ishin gra.

OShC-të raportuan se që nga maji, gjykatat kishin shqyrtuar 171 kërkesa nga viktimat e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje që kishin kërkuar urdhër mbrojtjeje. Gjykatat lëshuan 123. Gjykatat e Shkupit, Ohrit dhe Tetovës njoftuan se shumica e mocioneve kërkonin urdhra për mbrojtje nga dhuna fizike. Gjykatat e Gostivarit dhe Kavadarit njoftuan për nga një rast të femicidit. Gjykata Themelore e Ohrit dënoi një të pandehur me dy vjet burg për femicid.

Qeveria drejtoi tetë qendra rajonale për viktimat e dhunës në familje që strehuan 34 viktima gjatë vitit, nga të cilat 19 ishin gra dhe 15 fëmijë. Në bashkëpunim me sektorin e shoqërisë civile, qeveria financon një qendër për viktimat e dhunës në familje dhe një qendër krize, e cila kujdeset për viktimat për 24 deri në 48 orë pas sulmit. Një OJQ vendase ka punuar me një kontakt-linjë telefonike në maqedonisht dhe shqip, si dhe me dy qendra krize për strehim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje. Sipas Rrjetit Kombëtar të OSHC-ve për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, masat e qeverisë në mars 2020 për t'iu përgjigjur pandemisë së KOVID-19 thelluan dallimet ekzistuese gjinore dhe vendosën barrën e krizës kryesisht mbi gratë. Shumë nga masat mbetën në fuqi gjatë vitit. Dhuna ndaj grave u rrit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të KOVID-19 dhe qasja në shërbimet mbështetëse u ul si rezultat i masave të karantinës të lëshuara nga qeveria. OSHC-të hapën linja telefonike në mars 2020 për viktimat dhe njoftuan se merrnin telefonata çdo ditë.

Linja Kombëtare e Lëvizshme SOS Falas e Ministrisë së Punës për Viktimat e Dhunës në Familje vazhdoi të funksionojë gjatë gjithë vitit. Linja SOS dhe fushata ofruan ndihmë gjatë gjithë kohës, duke qenë të përpiktë, në kohë dhe konfidenciale, duke përfshirë informacion mbi mbrojtjen e viktimave, shërbimet që ofrohen dhe këshillimin telefonik për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe në familje.

Avokati i Popullit i karakterizoi dënimet e gjykatave kundër autorëve të dënuar si "tepër të butë" dhe tha se ato nuk kontribuan në zvogëlimin dhe eliminimin e formave të rënda të dhunës në familje dhe as nuk ofruan mbrojtje të mjaftueshme për viktimat.

Ngacmimi seksual: Ligji e ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës ndaj burrave dhe grave dhe jep udhëzime për shqiptimin e dënimit prej tre muaj deri në tre vite burg. Kur viktimat ndoqën rrugën ligjore, qeveria efektivisht zbatoi ligjin. Megjithatë, ngacmimi seksual i grave në vendin e punës mbeti një problem dhe viktimat përgjithësisht nuk ngritën padi për shkak të frikës nga publicitetit dhe humbjes së mundshme të vendit të punës.

Të drejtat riprodhuese: Nuk pati njoftime për abort të detyruar apo sterilizim të pavullnetshëm nga ana e autoriteteve qeveritare.

Gratë nga zonat rurale kishin qasje të kufizuar në këshillimin e planifikimit familjar dhe shërbimet gjinekologjike. Gratë rome u ndeshën me pengesa për të hyrë në këshillimin e planifikimit familjar dhe shërbimet gjinekologjike për shkak të diskriminimit, nivelit të lartë të varfërisë dhe numrit të ulët të mjekëve dhe gjinekologëve amë në komunitetet e tyre.

Në prill, me ndihmën e Ministrisë së Shëndetësisë, një mjek specialist vendas hapi një ordinancë gjinekologjike të kujdesit primar, në Shuto Orizari, duke siguruar qasje më të lehtë në kujdesin mjekësor dhe shërbimet e planifikimit familjar për rreth 20,000 gra kryesisht rome.

Qeveria siguroi akses në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Kontracepsioni i urgjencës ishte në dispozicion si pjesë e trajtimit klinik të përdhunimit. Ekzistonin tre qendra për të mbijetuarit e dhunës seksuale në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë; gjatë vitit qendrat u integruan dhe u financuan nga spitalet shtetërore në secilin qytet. Një strehë në Shkup për viktimat e trafikimit ofroi gjithashtu kujdes shëndetësor riprodhues.

Diskriminimi: Gratë kanë të njëjtin status ligjor si burrat sipas ligjeve të familjes, fesë, statusit personal dhe kombësisë, si dhe ligjeve që lidhen me punën, pronën, kombësinë, trashëgiminë, punësimin, qasjen në kredi dhe zotërimin ose menaxhimin e bizneseve ose pronës. Ligjet u zbatuan në mënyrë efektive. Në disa komunitete, praktika e burrave që drejtojnë votimin ose votojnë në emër të anëtarëve femra të familjes, ka privuar gratë nga e drejta e tyre.

Nuk pati ankesa përpara Avokatit të Popullit apo Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për trajtimin e pabarabartë të grave në jetën politike deri më 31 gusht.

Dhuna dhe diskriminimi sistematik racor ose etnik

Vendi ka ligje civile dhe penale dhe rregullore të veprimit afirmativ për të mbrojtur anëtarët e grupeve racore apo etnike nga dhuna dhe diskriminimi. Kushtetuta dhe ligjet u referohen pakicave etnike si bashkësi. Sipas zyrës së Avokatit të Popullit, pakicat më të vogla etnike me përjashtim të serbëve dhe vllahëve mbeten të nën-përfaqësuara në shërbimin civil dhe institucione të tjera shtetërore e publike.

Sipas raporteve të besueshme, pjesëtaret e komunitetit rom qenë subjekt i diskriminimit në mjediset publike dhe infrastrukturën publike të disa zonave urbane. Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi ndërmori veprim të efektshëm për të sanksionuar këto raste, duke lëshuar paralajmërime publike ose duke vendosur masa korrigjuese. Më 25 shtator, SSB i Ministrisë së Punëve të Brendshme pezulloi dhe më pas ngriti padi penale kundër një efektivi policie. Më 10 nëntor, Gjykata Themelore e Manastirit dënoi një efektiv policie me një vit burg për përdorim e tepruar të forcës kundër një shtetasi rom në shtator 2020.

Më 24 qershor, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) solli vendim kundër Maqedonisë së Veriut, duke konstatuar shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ’Neni 14 (Ndalimi i Diskriminimit) në lidhje me Nenin 3 (Ndalimi i Torturës) në një rast që kishte të bëjë me një aplikant rom. GJEDNJ gjeti se autoritetet nuk arritën të kryejnë një hetim efektiv në motivet e mundshme raciste prapa abuzimit të dyshuar fizik nga anëtarët e njësisë "Alfa" gjatë një ndërhyrjeje policore në vitin 2013 në një lagje rome në Shkup.

Romët kanë njoftuar për diskriminim të gjerë shoqëror. OJQ-të dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë raportuar se romët shpeshherë janë refuzuar për punësim, ndërsa disa romë janë ankuar për mungesë të qasjes deri te shërbimet dhe përfitimet publike. Më 7 prill, në shënimin e Ditës së Romëve, Kryeministri Zoran Zaev njoftoi për një investim prej 61 milionë denarë (1.1 milionë dollarë) për të mbështetur Strategjinë e qeverisë për romët dhe për krijimin e një Fondi për Sipërmarrësit Romë me fonde fillestare prej 122 milionë denarë (2.2 milionë dollarë). Zaev njoftoi gjithashtu se qeveria, në bashkëpunim me BE-në, siguroi 20 milion denarë (385,000 $) për një projekt strehimi dhe ndihme sociale për 20 familje rome në Koçani.

Më 8 prill, një grup protestuesish u kërkuan autoriteteve lokale të tërheqin vendimin për të ndërtuar apartamente për familjet rome në Koçani. Protestuesit mbanin pankarta me slogane "Mbi trupat tanë të vdekur", dhe "Nuk ka vend për ta këtu". Familjet rome për të cilët bëhej fjalë kanë jetuar në kazermat ushtarake në kushte nën standard për më shumë se dy dekada.

Lëvizja rome AVAJA dhe Shoqata Stanica 5 njoftuan për një rast diskriminimi kundër një grupi fëmijësh romë që nuk u lejuan të hyjnë në një pishinë publike në Prilep më 24 qershor. Rasti u raportua në Komisionin për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kryetari i Komunës së Prilepit dhe OSHC-të e drejtuara nga romët dënuan këtë veprim në një konferencë të përbashkët shtypi më 25 qershor. Më pas, komisioni konstatoi se stafi i pishinës publike të të Prilepit kishte diskriminuar këtë grup fëmijësh romë dhe rekomandoi që drejtuesit e pishinës t'u kërkojnë ndjesë publike viktimave nëpërmjet mediave tradicionale dhe sociale brenda 30 ditësh dhe të ofrojnë trajnim kundër diskriminimit për stafin e tyre ose të përballen me padi për kundërvajtje. Deri më 20 shtator, komisioni kishte konstatuar gjithashtu se personeli i Ndërmarrjes Publike të Transportit të Autobusëve të Shkupit kishte diskriminuar pasagjerët romë në të paktën dy raste të veçanta. Komisioni rekomandoi që kompania të ofrojë trajnim kundër diskriminimit për stafin e saj.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Ligji e përcakton shtetësinë në radhë të parë sipas shtetësisë së prindërve. Ai gjithashtu parasheh mundësinë që të t'u njihet shtetësia fëmijëve të gjetur në territorin e vendit nëse nuk njihen prindërit, përderisa autoritetet nuk zbulojnë që prindërit janë të huaj para moshës 18-vjeçare të fëmijës. Të gjitha lindjet në spitale dhe institucione mjekësore janë regjistruar automatikisht dhe ligji kërkon që të gjithë fëmijët, përfshirë edhe ata që kanë lindur në shtëpi, të regjistrohen në zyrat e ofiqarit brenda 15 ditëve nga dita e lindjes. Disa familje rome e kanë vonuar regjistrimin e foshnjave të lindura, duke ia vështirësuar atyre qasjen në përfitimet arsimore, mjekësore dhe përfitime tjera në jetë, për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit.

Arsimi: Ligji parashikon arsimin fillor në maqedonisht, shqip, turqisht, serbisht dhe boshnjakisht dhe arsimin e mesëm në maqedonisht, shqip dhe turqisht. Fëmijëve romë dhe vllahë në disa shkolla të arsimit fillor mësimi i gjuhëve dhe kulturave të tyre amtare u ofrohet si lëndë zgjedhore. Numri i nxënësve të minoriteteve që në shkollën e mesme arsimohen në gjuhën amtare vazhdoi të rritet.

Në shtator, shtypi ka njoftuar se prindërit e nxënësve në Bërnjarci, Vizbeg dhe Idrizovë janë ankuan përsëri se Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe qeverisja lokale nuk kanë ofruar një mundësi për fëmijët e tyre që të ndjekin shkollën në

gjuhën shqipe në vendin ku banonin. Fëmijët e tyre u transportuan në një fshat aty pranë ku ata ishin në gjendje të mësonin në gjuhën amtare.

Keqpërdorimi i fëmijëve Ka ligje kundër keqpërdorimit të fëmijëve dhe dënimet përfshijnë gjoba, burgim dhe mbylljen e bizneseve. Keqpërdorimi i fëmijëve ka qenë problem në disa rajone. Qeveria ka operuar me një linjë telefonike për dhunën në familje, përfshirë edhe keqtrajtimin e fëmijëve. Ministria e Punëve të Brendshme ka regjistruar 83 fëmijë në rrugë që janë detyruar nga prindërit e tyre apo të rritur të tjerë të lypin, të lajnë makinat apo të shesin sende të vogla. Të gjithë 83 fëmijët janë dërguar në qendrat e kujdesit ditor për fëmijët në rrezik.

Martesa në fëmijëri, e hershme dhe e detyruar: Mosha minimale ligjore për martesë është mosha 18-vjeçare. Gjykata mund ta lejojë martesën për personat e moshës 16-18 vjeçare, në qoftë se konstaton se kanë aftësi mendore dhe fizike për martesë. Martesat e detyruara dhe të hershme kanë ndodhur tek bashkësia rome dhe në masë shumë më të vogël në bashkësinë etnike shqiptare. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dokumentoi 32 martesa të hershme, në të cilat një ose të dyja palët ishin 16 ose 17 vjeç.

Ministria e Shëndetësisë raportoi se shkalla e shtatzënisë për vajzat dhe gratë e moshave nga 15 deri në 19 vjeç në vitin 2020 ishte 18,9 për qind, ndërsa përqindja e lindjeve për të njëjtën grup-moshë ishte 16,7 për qind. Shkalla kombëtare e lindjeve është 4.9 për qind.

Eksploatimi seksual i fëmijëve: Ligji e ndalon pornografinë e fëmijëve dhe dënimet për këtë janë prej pesë deri në 15 vite burg. Ligji e ndalon pornografinë e fëmijëve dhe dënimet për këtë janë prej pesë deri në 15 vite burg. Autoritetet kanë zbatuar ligjin. Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pajtim është mosha 16-vjeçare.

Eksploatimi seksual për qëllime komerciale i fëmijëve është konsideruar si problem nga autoritetet, por nuk i kanë ditur përmasat. Deri me 1 dhjetori, Qendra për Punë Sociale dhe Ministria e Brendshme identifikuan pesë viktima të mitura të trafikimit, nga të cilat tre ishin viktima të martesave të detyruara, një e lypjes së detyruara dhe një e shfrytëzimit seksual. Vendi kishte një regjistër online, ku informacioni kërkohej me emër dhe adresë, të trafikantëve të dënuar të fëmijëve dhe shkelësve të seksit me fotografitë, dosje të dënimeve dhe adresat e banimit. Autorët kanë mundësinë t'u kërkojnë autoriteteve t'i heqin nga regjistri 10 vjet pasi të përfundonin dënimin, me kusht që të mos kryejnë një shkelje të re.

Deri më 30 qershori, në regjistër janë evidentuan gjithsej 281 shkelës (12 gra dhe 269 burra), shtatë prej të cilëve ishin dënuar gjatë vitit. Deri më 3 shtatori, 166 ishin liruar nga burgu dhe të tjerët vuanin dënime me burg nga dy deri në 20 vjet. Një person ishte në arrati.

Fëmijë të institucionalizuar: Që nga gushti 2020 fëmijët janë strehuar në jetimore të vogla me nga pesë deri gjashtë fëmijë për objekt me mbikëqyrje 24-orëshe nga punonjësit socialë dhe ofruesit e kujdesit për fëmijët. Të gjithë jetimët nën tre vjeç ishin në shtëpi adoptuese. Ministria e Punës gjithashtu kishte ndërmarrë hapa për të shkurtuar kohën e nevojshme për të birësuar fëmijë jetimë ose të braktisur. Nuk pati njoftime për abuzim të fëmijëve në këto strehime shtëpiake gjatë vitit.

Institucioni edukativo-korrektuese për të miturit në Vollkovi - Tetovë u hap në nëntor 2020 dhe strehoi 16 të mitur gjatë vitit. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut mori pjesë në hapjen e institucionit dhe e karakterizoi atë si një strukturë të pajisur mirë dhe të organizuar që përmbushi plotësisht kriteret e përcaktuara për strehimin e të miturve dhe siguroi rehabilitimin e përshtatshëm dhe shërbimet mjekësore.

Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve Shteti është palë-nënshkruese e Konventës së Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (1980). Shikoni *Raportin Vjetor të Departamentit të Shtetit për Rrëmbimin Ndërkombëtar të Fëmijëve nga Prindërit në* at https://travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/for-providers/legal-reports-and-data/reported-cases.html.

Antisemitizmi

Sipas Komunitetit hebre, në vend banojnë rreth 250 hebrenj. Komuniteti nuk raportoi veprime të dhunshme kundër tyre por tha se gjatë shkallëzimit të konfliktit në Gaza, disa nga anëtarët e saj u ankuan se fëmijët e tyre qenë ngacmuar për identitetin e tyre hebre, veçanërisht ata që ndiqnin shkollat ndërkombëtare së bashku me fëmijët e diplomatëve dhe biznesmenëve nga bota arabe.

Gjuha antisemite dhe incidentet në vend ndodhën rrallë dhe në mënyrë sporadike, zakonisht në mediat sociale. Një dokument studimor i marsit nga OJQ Metamorfozis mbi dezinformimin e lidhur me KOVID-19 nxori në pah se dezinformimi dhe teoritë konspirative gjithashtu kishin rezultuar me gjuhën anti-semite dhe të urrejtjes në internet.

Disa protestues kundër vaksinimit përdorën simbolin e Yllit të Davidit kundër masave qeveritare të lidhura me pandeminë KOVID-19, duke krahasuar trajtimin e tyre nga qeveria me trajtimin e popullit hebre në Holokaust.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Shikoni Raportin e Departamentit të Shtetit *për trafikimin me qenie njerëzore* në https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/..

Personat me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara nuk kishin gjithmonë qasje në arsim, shërbime shëndetësore, ndërtesa publike dhe transport në një bazë të barabartë me të tjerët. Kushtetuta dhe ligji mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore), duke përfshirë qasjen e tyre ndaj arsimit, punësimit, shërbimeve shëndetësore, informacionit, komunikimit, ndërtesave, transportit, sistemit gjyqësor ose shërbimeve të tjera shtetërore, por këto detyrime ligjore nuk janë zbatuar gjithmonë në mënyrë efektive. Ligj i veçantë rregullon punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe plotëson ligjin e punës. Sipas ligjit, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore duhet të marrin aprovim nga komisioni mjekësor i Qeverisë, për të shërbyer në pozita mbikëqyrëse në sektorin privat dhe atë qeveritar. Ekspertët e personave me aftësi të kufizuara vlerësuan se kjo kërkesë cenonte të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për trajtim të barabartë dhe punësim në bazë të meritës.

Qeveria nuk ka një kuadër strategjik në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe as një plan veprimi për zbatimin efektiv të strategjisë gjithëpërfshirëse për deinstitucionalizimin. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përjetuan stigmatizim dhe ndarje për shkak të paragjykimeve të rrënjosura dhe mungesës së informacionit, përfshirë disa informacione të komunikuara nga qeveria për shkak të mungesës së formateve të qasshme.

Gjatë pandemisë, personat me aftësi të kufizuara u margjinalizuan dhe nevojat e tyre nuk u trajtuan, sipas OJQ-së Inkluziva, OJQ-ve të tjera dhe Avokatit të Popullit. Informacioni për KOVID-19 dhe faqet e internetit për aplikimin e vaksinave nuk u ofruan në formate të qasshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe shumica e objekteve të testimit për KOVID-19 nuk ofronin qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Më 15 shtator, parlamenti ndryshoi Kodin Zgjedhor për të lejuar personat me disa lloje paaftësish intelektuale të votonin, me kusht që e drejta e tyre e votës të mos hiqej me urdhër gjykate.

Ligji kërkon që ndërtesat e reja të ndërtohen sipas standardeve për qasje të lehtë, ndërsa objektet ekzistuese publike duhej ta mundësojnë qasjen për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2015. OJQ-të njoftuan se shumë ndërtesa publike e qeveritare dhe infrastruktura të tjera, duke përfshirë strehime për viktimat e dhunës, nuk përputheshin me ligjin. Ndonëse të gjithë autobusët e blerë që nga viti 2013 nga qeveria për Shkupin ofronin qasje për personat me paaftësi fizike, në praktikë shumë autobusë mbetën pa këtë qasje për shkak të mirëmbajtjes së pamjaftueshme, mungesës së trajnimit dhe dështimit për të sanksionuar shoferët që nganjëherë refuzonin të shtrinin rampat. Transporti publik jashtë Shkupit mbeti kryesisht pa qasje.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje për të siguruar mbështetje adekuate për t'ua mundësuar vijimin e shkollimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta. Ligji i arsimit fillor i vitit 2019 parasheh përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të rregullta/të integruara dhe parashikon transformimin e shkollave "speciale" në qendra burimore për mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Megjithatë, shumica e shkollave mbetën të papërgatitura për të zbatuar ligjin dhe vazhduan të luftojnë për të siguruar mbështetjen e duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga përpjekjet e Ministrisë së Arsimit. Shumica e shkollave mbetën pa qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe pa rampa për karriget me rrota, tualete speciale dhe ashensorë. Mbështetësit njoftuan se ligji i vitit 2019 ishte në dobi të fëmijëve me autizëm, pasi kishte më shumë pranim të tyre në shkolla, ku ata shpesh shoqëroheshin nga ndihmës mësues. Pavarësisht përpjekjeve të cekura, një numër i madh i nxënësve me aftësi të kufizuara edhe më tej mësimin e ndjekin në shkollat të veçanta. Nuk ka pasur raporte për dhunë, ngacmim ose frikësim ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Stigmatizimi shoqëror për HIV dhe SIDA

Stigmatizimi shoqëror dhe diskriminimi kundër personave që jetojnë me HIV dhe SIDA mbetën një problem.

Ministria e Shëndetësisë nuk i përfshiu personat që jetojnë me HIV në kategoritë e qytetarëve me përparësi vaksinimin kundër KOVID-19, pavarësisht kërkesës me shkrim të OSHC-ve për përfshirjen e tyre. Pandemia përkeqësoi problemet sistemike

të përjashtimit social, aksesin e kufizuar në shërbimet publike dhe drejtësinë dhe mbrojtjen e papërshtatshme nga diskriminimi dhe dhuna kundër njerëzve që jetojnë me HIV. Kufizimet në lëvizje dhe transportin publik prekën drejtpërdrejt njerëzit që jetojnë me HIV, veçanërisht ata që banojnë jashtë kryeqytetit, pasi kujdesi shëndetësor për këtë grup është i centralizuar dhe terapia antiretrovirale administrohet vetëm në Klinikën Shtetërore për Sëmundjet Infektive dhe Gjendjet Febrile në Shkup. Organizatat për mbështetjen e personave me HIV, në bashkëpunim me Klinikën për Sëmundje Infektive, mbështetën shpërndarjen falas të terapisë antiretrovirale për të gjithë pacientët me HIV në nevojë, dhe veçanërisht për ata që jetojnë jashtë kryeqytetit.

Aktet e dhunës, kriminalizimi dhe abuzime të tjera bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Kur viktimat paraqitën ankesa, qeveria përgjithësisht zbatoi ligjin.

Komuniteti lesbik, homoseksual, biseksual, transgjinor, kvir dhe ndër-seksual (LGBTQI+) ka mbetur i margjinalizuar dhe aktivistët që mbështesin të drejtat e LGBTQI+ kanë raportuar incidente të shumta të paragjykimit shoqëror, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes. Ligji kundër diskriminimit në mënyrë eksplicite mbron personat kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor në arsim, punësim, strehim dhe kujdes shëndetësor; nuk ka mbrojtje kundër gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor brenda Kodit Penal dhe ligjeve të tjera që mbulojnë lirinë e shprehjes.

Deri më 26 nëntori, Komisioni Shtetëror për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi kishte shqyrtuar nëntë ankesa që pretendonin diskriminim bazuar në gjininë ose orientimin seksual. Komisioni përcaktoi se kishte prova të mjaftueshme për të provuar pesë nga nëntë pretendimet dhe rekomandoi veprime korrigjuese ndaj subjekteve përgjegjëse. Rekomandimet e Komisionit e përfshinin ndjesën publike ndaj personave të prekur dhe detyrimin e punëdhënësve për të ofruar trajnim për stafin. Një nga rastet, që e kishte ngritur Koalicioni i OSHC-ve Margjina, kishte të bëjë me grua transgjinore e cila u ishte diskriminuar në një farmaci. Komisioni rekomandoi që farmacia të kryejë trajnime për punonjësit e saj për të punuar me klientët LGBTQI +.

Në qershor, para Paradës së Krenarisë në Shkup, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Arjanit Hoxha bëri një deklaratë publike që i karakterizoi

personat LGBTQI + si "të pamoralshëm" dhe "të sëmurë". OJQ-ja Fronti Subversiv u ankua, duke vënë në dukje midis të tjerash se komentet e ministrit mund të ngjallin frikë midis personave LGBTQI + dhe familjeve të tyre.

Nuk ka pasur praktika mjekësore ose psikologjike të pavullnetshme ose shtrënguese që kanë synuar në mënyrë specifike personat LGBTQI +. Terapia e konvertimit është praktikuar, por informacioni rreth rasteve specifike rrallë ka arritur deri tek mbrojtësit. Aktivistët njoftuan se psikologët dhe profesionistët e tjerë arsimorë në shkolla shpesh u kanë kërkuar studentëve LGBTQI + të pranonin standardet heteronormative dhe të vepronin në përputhje me rolet e pritshme të gjinisë që u ishin caktuar në lindje.

Dhuna ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTQI + ka mbetur si problem. Koalicioni Margjinat dokumentoi 29 shkelje të të drejtave të personave LGBTQI +, duke përfshirë 18 raste të gjuhës së urrejtjes. Dy nga rastet e dokumentuara që ka gjasa të përbëjnë krime të urrejtjes u denoncuan në polici. Gjatë rrugës për në shtëpi pas Paradës së Krenarisë, një pjesëmarrës u sulmua fizikisht për shkak të orientimit të tij seksual. Rasti është denoncuar në polici. Sulmi u cilësua si krim nga urrejtja, por nuk kishte informacion për ndonjë ndjekje të mëvonshme. Në një rast tjetër, një çift ka raportuar se ishte sulmuar në park të qytetit, por policia kishte refuzuar të regjistrojë ankesën e tyre. Policia shkroi në raport se viktimat ishin "dy shoqe femra", jo një çift. Raste të tjera të raportuara përfshinin ngacmime homofobike dhe seksuale në vendin e punës dhe dhunën në familje. Më 29 nëntor, LGBTQI + dhe aktivistë të tjerë të të drejtave të njeriut kishin protestuar para Prokurorisë Publike për mos ngritjen e hetimit në pesë sulme të veçanta në 2012 dhe 2013 kundër individëve LGBTQI +, duke përfshirë një sulm të dhunshëm kundër një aktivisti LGBTQI + dhe shkatërrimin e një qendre të komunitetit LGBTQI + në Shkup. Sipas komunitetit LGBTQI +, pandëshkueshmëria e sulmeve shkaktoi frikë midis individëve LGBTQI + dhe nxiti kërcënime të drejtpërdrejta dhe publike ndaj anëtarëve të këtij komuniteti dhe familjeve dhe miqve të tyre.

Në qershor, OShC-të lokale organizuan paradën e tretë vjetore të Krenarisë në Shkup. Zyrtarët qeveritarë, duke përfshirë presidentin dhe ministrat e mbrojtjes, arsimit, kulturës dhe politikës sociale, morën pjesë në ngjarjet e krenarisë. Politikanët e opozitës nuk morën pjesë dhe partia opozitare VMRO-DPMNE lëshoi një deklaratë duke akuzuar qeverinë për hipokrizi sepse mbështet paradën ndërsa "brutalisht shkelë" të drejtat themelore të qytetarëve të tjerë. Ngjarjet e krenarisë përkuan me një rritje të incidenteve të gjuhës së urrejtjes dhe sulmit të individëve LGBTQI +.

Shtatë raste u denoncuan në polici dhe prokurori publike. Deri më 4 tetor, asnjë nga këto raste nuk ishte përpunuar nga autoritetet.

Pjesa 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e shoqërimit dhe e drejta për negociata kolektive

Ligji e parasheh të drejtën e themelimit dhe anëtarësimit në sindikata të pavarura, marrëveshje kolektive dhe të drejtën e grevës. Ligji ndalon diskriminimin për aktivitete sindikaliste dhe siguron kthimin në punë të punëtorëve të larguar nga puna për këtë arsye. Sindikatat bazohen në anëtarësim vullnetar dhe aktivitetet financohen nga anëtarësia. Përafërsisht 22 për qind e të punësuarve ishin anëtarë të sindikatës.

Përfaqësuesit e sindikatës, me përjashtim të disa sindikata të degëve, kanë pretenduar se përgjithësisht nuk ishin të lirë nga ndikimi i zyrtarëve qeveritarë, partive politike dhe punëdhënësve.

Ligji kërkon që sindikatat e bashkuara të regjistrohen në Ministrinë e Punës dhe në Regjistrin Qendror të Shtetit.

Një gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm mund të ndërpresë aktivitetet sindikale me kërkesë të Regjistrit Qendror ose gjykatës kompetente, kur këto aktivitete konsiderohen të jenë "kundër kushtetutës dhe ligjit." Nuk ka kufizime shtetësie për anëtarësimin në sindikata, ndonëse shtetasit e huaj duhet të kenë leje të vlefshme pune dhe të jenë të punësuar nga kompania ose organi qeveritar i përcaktuar në lejen. Megjithëse lejohet ligjërisht, asnjë sindikatë nuk është aktive në zonat e lira ekonomike.

Qeveria dhe punëdhënësit nuk kanë respektuar gjithmonë lirinë e shoqërimit, të drejtën e grevës dhe të drejtën e marrëveshjes kolektive. Sindikatat kanë dhënë si dëshmi dispozitën "përjashtuese" të ligjit që lejon që punëdhënësit të përjashtojnë deri në 2 për qind të punëtorëve nga negociatat kolektive gjatë grevës. Marrëveshja kolektive lejohet vetëm për sindikatat që përfaqësojnë të paktën 20 për qind të të punësuarve dhe shoqatat e punëdhënësve që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të punëdhënësve në nivel në të cilin është lidhur Marrëveshja (kompani, sektori, ose vendi). Mjetet qeveritare të ekzekutimit dhe mjetet juridike kanë qenë të pamjaftueshme. Dënimet për shkelje qenë në proporcion me ato të ligjeve të tjera që përfshinin mohimin e të drejtave civile. Procedurat administrative dhe gjyqësore përgjithësisht kanë pësuar vonesa të gjata.

Ligji mbulon të gjithë punëtorët e punësuar ligjërisht nga punëdhënësit që janë regjistruar rregullisht dhe nuk diskriminon punëtorët e huaj apo emigrantët që janë punësuar ligjërisht në vend. Gjatë vitit Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) i Ministrisë së Punës nuk ka marrë asnjë ankesë në lidhje me shkeljen e të drejtës së organizimit sindikal dhe lirisë së shoqërimit. Punëtorët shpesh i trembeshin hakmarrjes dhe përmbaheshin nga paraqitja e ankesave drejtpërsëdrejti në Ministrinë e Punës. Aty ku ka qenë e mundur, sindikatat kanë paraqitur ankesa në emër të punëtorëve.

Derin më 20 gushti, ISHP kishte marrë një ankesë nga Konfederata e Sindikatave të Lira (KSL) duke pretenduar se Ministria e Punës nuk iu përgjigj kërkesës së tyre për t'u njohur si një sindikatë përfaqësuese me autoritet për të negociuar marrëveshjet kolektive të degëve. Ministria njoftoi se e kishte refuzuar aplikimin e KSL-së për shkak se nuk demonstroi se KSL kishte përmbushur pragun e kërkuar ligjërisht për përfaqësimin e forcës punëtore.

Avokati i Popullit mori nëntë ankesa nga Sindikata Maqedonase e Policisë, duke pretenduar se disa efektivë ishin caktuar për të kryer detyra jashtë fushës së përshkrimit të punës së tyre për periudha më të gjata se ç'është përcaktuar ligjërisht. Sindikata dërgoi një ankesë në emër të një polici duke pretenduar se i është nënshtruar një veprimi disiplinor të pavend. Avokati i Popullit ka marrë një ankesë nga punonjësit e Ministrisë së Brendshme duke pretenduar se ministria, me kërkesën e sindikatës, kishte filluar të ndalte pagesën për anëtarësim në sindikatat nga pagat e anëtarëve pa e votuar anëtarët këtë. Hetimet e Avokatit të Popullit mbi ankesat qenë pezull deri më 20 gusht.

b. Ndalimi i punës së detyruar

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të gjitha format e punës së detyruar, ndërsa Qeveria ka zbatuar në masë të madhe ligjet në fuqi. Ligji parashikon një dënim me burg për shkelje në lidhje me punën e detyruar apo për shkatërrimin ose për marrjen e dokumentit të identifikimit, pasaportës apo dokumenteve të tjera të udhëtimit. Dënimet për shkelje qenë në përpjesëtim me ato për krime të tjera të rënda. Ka pasur raste në të cilat gratë dhe fëmijët i janë nënshtruar punës së detyruar, siç është shitja e gjërave të vogla, në restorante dhe bare, dhe shfrytëzimi seksual. Disa fëmijë romë kanë qenë të detyruar të lypin, shpesh nga të afërmit (shih pjesën 7.c.).

ISHP ka kryer inspektime të rregullta për të verifikuar respektimin e ligjeve të punës, ka lëshuar paralajmërime dhe gjoba dhe ka sanksionuar bizneset. Qeveria nuk

vendosi një linjë të hapur, por Ministria e Brendshme vendosi një aplikacion për të raportuar shkelje të ndryshme, duke përfshirë trafikimin; përmes aplikacionit u paraqitën shkelje lidhur me trafikimin. Qeveria nuk bëri përpjekje për të reduktuar kërkesën për seks komercial.

Gjithashtu shih Raportin e Departamentit për *Trafikimin me qenie njerëzore* në https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/.

c. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mosha minimale për punësim

Qeveria ka vendosur ligje dhe rregullore në lidhje me punën e fëmijëve, duke përfshirë ndalimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve. Qeveria ka bërë përpjekje për të zbatuar ligjin në ekonominë formale, por nuk e ka bërë këtë në mënyrë efektive në ekonominë joformale. Ekzistojnë boshllëqe në kornizën ligjore të vendit për të mbrojtur fëmijët në mënyrë adekuate nga abuzimet e punës, duke përfshirë format më të këqija të punës së fëmijëve dhe moshën minimale për punë. Mosha minimale për punësim është 15 vjeç. Fëmijët mund të fillojnë të punojnë në moshën 14 vjeçe si praktikantë ose si pjesë e programit zyrtar të arsimit profesional, ngjarje kulturore, artistike, sportive dhe reklamuese. Ligji e ndalon punësimin e të miturve nën moshën 18-vjeçare në vendet e punës që e dëmtojnë shëndetin e tyre psikik ose psikologjik, ose moralin. Gjithashtu ndalon të miturit të punojnë natën ose më shumë se 40 orë në javë.

Inspektorati i Punës është përgjegjës për zbatimin e ligjeve që e rregullojnë punësimin e fëmijëve. Policia dhe Ministria, përmes qendrave për punë sociale, ndajnë përgjegjësinë për zbatimin e ligjeve mbi trafikimin e fëmijëve, duke përfshirë lypjen e detyruar. Qeveria nuk zbatoi me efektivitet ligjin, ndonëse ndëshkimet për shkeljet qenë në proporcion me ato për krime të rënda analoge.

Nuk kishte raporte për fëmijë nën 18 vjeç të angazhuar në mënyrë të paligjshme në ekonominë formale. Gjatë inspektimeve në disa biznese të drejtuara nga familja, Inspektorati Shtetëror i Punës ka vërejtur fëmijë të mitur që ndihmojnë në punë, më së shpeshti në artizanat të drejtuar nga familja dhe bizneset me pakicë, si dhe në ferma.

Puna e fëmijëve ka ndodhur në bujqësi, punë shtëpiake dhe në bare e klube nate. Disa fëmijë në vend ishin marrë me lypje të detyruar, pastrimin e xhamave; pastrimin, ose shitjen e cigareve ose sendeve të tjera të vogla në tregje të hapura, në rrugë, ose në bare dhe restorante gjatë natës. Ndonëse ekzistojnë ligjet e nevojshme

në vend, përpjekjet e Qeverisë për eliminimin e lypjes së detyruar të fëmijëve kanë qenë kryesisht të paefektshme. Fëmijët e përfshirë në këto aktivitete kanë qenë kryesisht romë, ashkali dhe ballkano-egjiptianë dhe më shpesh kanë punuar për prindërit e tyre ose familjarë të tjerë. Përkundër zbatimit të mjeteve juridike, siç janë heqja e përkohshme e të drejtave prindërore, padive penale dhe revokimin e të drejtave prindërore të shkelësve të përsëritur, zyrtarët kanë qenë kryesisht të paefektshëm në parandalimin e kësaj praktike të vazhdueshme, dhe fëmijët romë kanë mbetur të cenueshëm ndaj eksploatimit dhe punës së detyruar.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit ka vazhduar të shpreh shqetësime rreth lypjes së fëmijëve dhe ka kritikuar Qendrat e Punës Sociale dhe masat e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale si të papërshtatshme për të kapërcyer një dukuri të vazhdueshme që shkel të drejtat e fëmijëve.

Ministria e Punës drejton një qendër telefonike ku mund të raportohet abuzimi i fëmijëve, dhe shumica e raporteve kishin të bëjnë me lypjen në rrugë. Ministria gjithashtu ka financuar dy qendra të kujdesit ditor ku është siguruar edukimi, shërbimet mjekësore dhe psikologjike për fëmijët që detyrohen të lypin në rrugë.

Shih gjithashtu gjetjet e Departamentit të Punës *mbi format më të këqija të punës së fëmijëve* në https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/findings.

ç. Diskriminimi në lidhje me punësimin dhe profesionin

Ligjet dhe rregulloret e punës në përgjithësi e ndalojnë diskriminimin në lidhje me racën, identitetin gjinor, ngjyrën, aftësitë e kufizuara, gjendjen shëndetësore, fenë, moshën, prejardhjen kombëtare, gjuhën apo statusin shoqëror. Ligji nuk adreson diskriminimin në bazë të virusit HIV apo ndonjë statusi me ndonjë sëmundje tjetër ngjitëse, por i referohet statusit shëndetësor të punonjësve. Qeveria nuk zbatoi gjithmonë me efektivitet ligjin, ndonëse ndëshkimet për shkeljet qenë në proporcion me ato të ligjeve të tjera për të drejtat civile.

Pavarësisht nga përpjekjet e Qeverisë dhe ndryshimet ligjore për përfshirjen e detyrueshme në arsimin fillor dhe të mesëm, romët kanë vazhduar të jetojnë në grupe të veçuara, pa mbrojtje shëndetësore dhe sociale përkatëse, kryesisht për shkak të mungesës së dokumenteve të regjistrimit. Të dhënat nga Zyra Shtetërore e Punësimit kanë treguar se për shkak të pjesëmarrjes së ulët në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e lartë, romët në përgjithësi kanë pasur vështirësi në gjetjen e një punë në

ekonominë formale. Pagat e grave kanë ngecur pas atyre të burrave dhe të pakta kanë qenë gratë në poste drejtuese. Sipas ligjit, grave u ndalohet të punojnë në pozicione të caktuara "me rrezik të lartë" dhe "me ngarkesë fizike" në minierat dhe ndërtim. Qeveria ka bërë përpjekje për parandalimin e diskriminim në punësim dhe në qasje në vendin e punës për personat me aftësi të kufizuara.

d. Kushtet e pranueshme të punës

Ligjet e pagave dhe orëve të punës: Ligji përcakton një pagë minimale në të gjithë sektorët, e cila është nën nivelin e të ardhurave të varfërisë.

Numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës ka qenë i përshtatshëm për të hetuar shkeljet e ligjit të punës. Inspektorët e punës kanë autoritetin të bëjnë kontrolle të paparalajmëruara dhe të shqiptojnë sanksione. Megjithatë, inspektimet nuk kanë qenë adekuate për të siguruar pajtueshmërinë pjesërisht për shkak të një shpërndarje joadekuate rajonale të inspektorëve.

Ligji parasheh një javë pune 40-orëshe me një periudhë pushimi minimal 24-orësh, pushime me pagesë nga 20 deri në 26 ditë pune dhe pushime mjekësore. Punonjësit nuk mund të punojnë legalisht më shumë se mesatarisht tetë orë punë jashtë orarit në javë për një periudhë tre-mujore ose 190 orë në vit. Sipas marrëveshjes kolektive për sektorin privat midis punëdhënësve dhe sindikatave, të punësuarit në sektorin privat kanë të drejtën e pagës së punës jashtë orarit me 135 për qind të normës së tyre të rregullt. Për më tepër, ligji u jep të drejtën punonjësve që punojnë më shumë se 150 orë punë jashtë orarit në vit për një shpërblim prej një pagë mujore.

Gjatë vitit, ISHP ka paraqitur padi kundër ndërmarrjeve për detyrimin e punëtorëve të punojnë me orar të gjatë pa pushimin e paraparë me ligj, mospagesën e rrogave, përfitimeve dhe punës jashtë orarit, si dhe për shkurtimin e pushimit të të punësuarve. Shkelje të jashtëzakonshme janë konstatuar sa u përket pagave dhe punës në sektorin e tekstilit, hekurudhave dhe shitjes me pakicë.

Paga minimale, orët e punës, si dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Dënimet për shkelje qenë në përpjesëtim me ato për krime të tjera të ngjashme. Shumë punëdhënës kanë punësuar punëtorë duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ndërsa bizneset e vogla të tregtisë shpeshherë kërkojnë që të punësuarit të punojnë edhe përtej orarit të përcaktuar me ligj. Përderisa punëtorët kanë të drejtë ligjore të largohen nga situatat që e rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e tyre pa e rrezikuar punësimin e tyre të ardhshëm,

punëdhënësit nuk e kanë respektuar gjithmonë këtë të drejtë, për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, sipas tyre.

Në një reagim të gjithë qeverisë ndaj ndikimeve ekonomike të KOVID-19, qeveria miratoi një sërë masash ekonomike dhe sociale për të ndihmuar bizneset dhe punonjësit. Masat përfshinin vendosjen e masave të distancimit fizik në vendet e punës, dhënien e subvencioneve për bizneset e sektorit privat për të mbajtur punonjësit e tyre dhe lejimin e një prindi të fëmijëve deri në moshën 10 vjeç për të qëndruar në shtëpi pa gjobë financiare.

Në vitin 2020, ISHP konstatoi 129 shkelje të të drejtave të punësimit që përfshinin pagat dhe përfitimet, si dhe performancën në punë. ISHP lëshoi 120 paralajmërime dhe nëntë urdhra për masa zbutëse. Miratoi një marrëveshje.

Siguria dhe shëndeti në punë: Ligji jep parimet themelore për parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve të lidhura me punën, dhe përputhet me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Punëdhënësit janë përgjegjës për vlerësimin e rreziqeve me të cilat përballen punonjësit e tyre në punë. Ligji u kërkon punëdhënësve të caktojnë një nëpunës të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP) ose të kontraktojnë një kompani të licencuar për të zbatuar standardet e SSHP-së. Deri në nëntor, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kishte lëshuar 55 licenca për kompanitë e SSHP-së.

Ligji lejon punëtorët të shmangin situatat që rrezikojnë shëndetin apo sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Nuk ka pasur raporte që pretendojnë se punonjësit humbur vendet e punës për shkak të shmangies nga situatat e rrezikshme gjatë punës.

Ministritë e Punës dhe Shëndetësisë, ISHP-ja dhe Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik janë përgjegjës për zbatimin e ligjeve përkatëse. ISHP-ja ka një Sektor të SSHP me tre zyra rajonale, por ato nuk kanë personel të mjaftueshëm dhe nuk kanë trajnim të duhur dhe pajisje moderne.

Deri në 30 gusht, ISHP mori 63 ankesa lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë. Për çdo parregullsi të dokumentuar, ISHP shqiptoi disa paralajmërime ose mbyllje të përkohshme dhe mbikëqyri zbatimin e vendimeve.

Deri në gusht ISHP ka regjistruar tetë lëndime fatale në vendin e punës. Në të gjitha rastet, inspektorët shtetërorë të punës kishin inspektuar vendin e ngjarjes, kishin

hartuare një raport dhe kishin marrë në përputhje me ligjin. Këto incidente kishin rezultuar me padi për kundërvajtje ose penale kundër punëdhënësve.

Sipas Shoqatës Maqedonase të Sigurisë në Punë, në vitin 2020 pati 152 lëndime në vendin e punës, nga të cilët 25 çuan në vdekje. Shumica e vdekjeve kanë ndodhur në kategorinë e Veprimtarive familjare, të cilat përfshinin bujqësinë dhe përdorimin e pajisjeve bujqësore, të ndjekura nga sektori i ndërtimtarisë.

Sektori joformal: Megjithëse Qeveria ka vendosur standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëdhënësit, këto standarde nuk janë zbatuar në sektorin joformal. Sektori joformal i ekonomisë përbën afërsisht 22 për qind të punësimit. Shumë punëtorë në sektorin joformal ishin meshkuj dhe përfshinin të rinj si dhe pensionistë që punonin në bujqësi. Pas bujqësisë, ndërtimi dhe tregtia konsiderohen si sektorët e ekonomisë me numrin më të madh të punëtorëve joformalë. Në shtator, Ministria e Financave dhe UNDP nisën një Projekt për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike, që ka për qëllim identifikimin e shkaqeve kryesore që nxisin punësimin në ekonominë joformale dhe planifikimin e saktë të sektorëve ku ai është më i përhapur.